



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.60/ 01-6206 /25
Kaçanik, 18.03.2025

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e III (tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 28 mars 2025 (e premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e III (tretë) të Kuvendit të Komunës të datës 28.03.2025 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtore të institucioneve arsimore;
3. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore ZK Bob;
4. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2024;
5. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik
01Nr. 060/01-4091/25
Kaçanik, 27.02.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 27.02.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës ishin 27 anëtarë-të gjithë.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani-DSHPE, Bahri Selimi-DBF, Suhad Dullovi- DBPZHR, Sali Malsiu-DSHMS, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Zahir Doda-DA, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: 2 zyrtarë nga DUKMM: Visar Mulaku dhe Rufat Muça, Valdrin Dogani-ZKF, Bejtulla Dalloshi-IT, Mavije Murseli-Zyra e Kryesuesit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit

Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Se pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e fillojmë mbledhjen e dytë të rregullt të KK për vitin 2025, data 27 shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;
3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024;
4. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024;
5. Informatë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për vitin 2024;
6. Informatë për Përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2024/2025;
7. Plani vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për periudhën Janar-Dhjetor 2025;
8. Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
9. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Elezaj dhe ZK Bob;
10. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të pjesëve Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik;
11. Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Kumrije Tali;
12. Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Adnan Vishi;
13. Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Burim Çallaku.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 13 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalit i mbledhjes së kaluar e Kuvendit të Komunës u aprovua pa vërejtje, me 26 votë Për. Nuk votoj Agim Mani, pasi nuk ka qenë pjesë e procesit. Prezentë 27. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 31.01.2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-2081/25.

Kryesuesi i Kuvendit: Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Naim Beça: 1. Në rrugën “ Besnik Begunca”, kamionët që kanë punuar në rregullimin e hekurudhës, nga pesha e rëndë e tyre, është prishur asfalti dhe gypat kanë pëlcitur. Ata i kanë vendosur kubëza në vend të asfaltit, kubëzat kanë pëlcitur. Ne nuk jemi duke pasur kubëza në qendër të qytetit, e lërë më në atë pjesë të vendosën në vend të asfaltit.

2. Në rrugën e Runjevës nga pesha e madhe e kamionëve, kanë pëlcitur gypat, janë bërë prerje e asfaltit nga “Bifurkacioni” dhe janë vendosur kubëza nga komuna.

Qytetarët kanë pasur ankesë zyrtare në komunë, por nuk është marrë askush me atë ankesë.

Rruga” Kemal Thaqi”-deri të shkolla në Runjevë, është bërë me vetëfinancim të komunitetit, tani ajo rrugë është prishur nga neglizhenca e komunës.

4. Rruga “Avdurrahim Shehu”, këtu po shihet se komuna nuk punon me “njohësi”. E themi këtë për arsye se drejtori i urbanizmit jeton në atë rrugë, është hera e pestë që po e potencoj se projekti i filluar nuk ka përfunduar, hekurat që janë vendosur duhet të priten ose të vazhdon ai projekt, se aty fëmijët kalojnë, dy fëmijë kanë ra nga lartë në një pronë private, se është lartësi e madhe. Ky projekt duhet të vazhdohet të kryhet sa me parë.

4. Në rrugën” Skënderbeu, ka kohë që asfalti nuk është rregulluar aty.

5. Kohëve të fundit e keni vërejtur se ka prerje të asfaltit në rrugët e qytetit, për rregullimin e gypave etj. A marrin leje qytetarët për me prerë asfaltin? Për këto 4 pika, pyetja është, a kanë me u rregulluar rrugët, se të njëjtën përgjigje po e marrim çdo herë, se është e kontraktuar kompania etj. Këto rrugë nuk janë rregulluar, ndërkaq duhet me dhënë një afat, kur kanë me u rregulluar.

6. Në shumtën e kohës të Bulevardi, që është pa emër, nuk po ka drita. Duhet me pasur kujdes me i ndezur dritat në atë pjesë, se njerëzit kalojnë atypari.

znj. Ardita Rrahmani: Fillimisht shprehi ngushëllime familjes dhe komunitetit artistik për ndarjen nga jeta të aktorit Lul Rexha.

Pyetjet dhe Kërkesat: Nga takimet e kontaktet me qytetare, dalin edhe kërkesat dhe shqetësimet e tyre, dhe sugjerimet për një jetë me të mirë.

1.Banorët e Zonës së parë të qytetit, pavarësisht taksave që paguajnë, nuk mbulohen me shërbime. Flas për rrugën “Ismail Qemali”, e cila nuk është e mbuluar me ndriçim publik, ndërkaq është rrugë shumë e banuar. Kur jemi të rrugët me emra të mëdhenj, është edhe rruga” Hamëz Jashari”, rrugë kjo e dëmtuar dhe vështirë të qarkullueshme. Gjendja nuk është me e

mirë as në Lagjen e Re. Laura në Dushkajë në drejtim të rrugës “Emsale Frangu”, është vështirë e kalueshme edhe në këmbë. Shpresoj të bëhet tani në pranverë sanimi i këtyre rrugëve.

2. Zhvillimi ekonomik i një vendi bëhet nga qytetarët, e kur ata nuk gjejnë alternativë jetese, ikin në vende tjera, e atëherë në atë vend nuk mundet me pasur zhvillim ekonomik. Si anëtare e KK, që përfaqësoj interesat e qytetarëve, mendoj se dhënia e lejeve ndërtimore të ish fabrika e Gëlqeres, dhe jo vetëm, të jetë shpresë dhe shtysë këtij vendi dhe jam e bindur që pastaj përmes konkurrencës së tregut, qytetarët nuk do të ikin në vende tjera me bërë zgjidhje për banim.

3. Ri përsërisë 2 pyetjet e mia nga seancat e kaluara që nuk kam marrë përgjigje: Kur do të bëhet rivendosja e fontanës të Ura e konakut,

4. Kur do të jetë funksional, komisioni për emërtimin e rrugëve.

z. Burim Shehu: 1. Një përgjigje me keni dhënë në pyetjen për të shtëpia Muze, është mirë me shkuar me shikuar se ishin ndryshkur krejt kubëzat. Ajo që ishte me e keqja se përroin aty dhe kroni e kanë zënë ata që kanë punuar dhe është krijuar ujë aty, ka dalë në kubëza. Pyetja ime ka qenë: Pse nuk është bërë rruga deri të shtëpia Muze? Rruga është mirë me u bërë dhe me shikuar gjendjen e kubëzave të kjo shtëpi.

2. Të rruga “Zija Loku”, iu keni premtuar banorëve për një shkarpë, shkarpa nuk është bërë, përgjigje nuk keni kthyer banorëve që 6 muaj.

z. Selajdin Troni: Kur të bëhen pyetjet dhe kërkesat, mos të elaborohen, sepse me tepër po bëhet politikë, duke “thënë vjersha”, sesa me bërë pyetjen e me pritur përgjigjen nga drejtoria Për një pyetje, i merrni 5 minuta, pyetja nuk i ka 5 minuta, kështu që duhet kryesues të mbani një rend, përndryshe unë kem me ndërhyrë sa herë kur eleborohen pyetjet dhe kërkesat.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundemi me iu përzier askujt si bënë formulimin e pyetjes.

znj. Lirije Dema: Kam një kërkesë për DSHPE, Rruga “Vëllezërit Çaka” është rrugë shumë e frekuentuar nga banorët dhe nxënësit të cilët vijnë në shkollën fillore “Idriz Seferi”, po ashtu edhe nga nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, pa lënë anash edhe banorët e qytetit që frekuentojnë në këtë rrugë për të kryer shërbime e tyre në tregun që gjendet rrugën “Vëllezërit Çaka”. Kjo rrugë ka nevojë për disa vendkalime, se vendkalimet ekzistuese janë të papërshtatshme për kalimin e këmbësorëve, sepse po iu krijohet pasiguri qytetarëve gjatë kalimit të tyre.

z. Betim Shala: 1. Në mbledhjen e kaluar e kam bërë një kërkesë, se a është futur në rrugët lokale, rruga: “Sylejman Kuka”, që ka 170-180 metra gjatësi, ndërkaq nuk kam marrë përgjigje.

2. Rruga të pllaka e Dëshmorëve në lagjen Kuka, që ka diku 550 metra gjatësi, a është në rend për me u rregullua?

3. Rruga Bob-Doganaj, sidomos pjesa prej f. Kovaçec deri të f. Nikaj, është shumë e dëmtuar nga Bektel Enka, ndërkaq nuk është marrë asnjë veprim për sanimin e saj. A do të merret ndonjë veprim i nevojshëm për riparimin e asfaltit të kësaj rruge?

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse keni ndonjë kërkesë, e parashtron, në të kundërtën Selajdini e pati pyetjen për mua, ndaj juve.

z. Naim Beça: Ne po hymë në elaborim të pyetjeve dhe kërkesave për shumë arsye: Ata kamionë kanë qenë të mbingarkuar, ndërkaq është në përgjegjësi të komunës, inspektorëve të komunës për me ruajtur asfaltin e vet. Përgjigjet nuk po i jepni të mira, sa herë po janë të njëjta përgjigjet.

z. Selajdin Troni: Ajo që po e thoni, është çështje e policisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Debati në këtë formë, nuk është në rregull. Ju i bëni pyetjet, i merrni përgjigjet.

znj. Ardita Rrahmani: Mendoj se është pika e diskutimit në mes neve, pastaj për pikat që i silleni ju, diskutojmë në vazhdim. Po i drejtohem kolegut tim, se po e ndiej obligim, jo me shfajësuar, por me treguar se kur e paraqes një shqetësim që me vjen prej dikujt, unë juve dhe shokëve tuaj duhet me iu treguar arsyen.

z. Selajdin Troni: Mundeni me ngrit pyetje dhe kërkesa, por jo me na thënë vjersha këtu duke i elaboruar të njëjtat.

znj. Ardita Rrahmani: Ju mundeni me debatuar edhe diku tjetër, ndërkaq unë jo, unë debatoj këtu në KK. Ju mundeni me i ngritur kërkesat dhe ankesat e juaja të kryetari i komunës dhe jo vetëm të diskutimi im, por të asnjë anëtarë tjetër nuk keni të drejtë me ndërhyrë në çështjet që i ngritin. Unë kërkesat dhe ankesat i ngriti këtu në këtë kuvend.

z. Rustem Zenuni: Kush iu ka ndal juve mos me i adresuar pyetjet dhe kërkesat të Kryetari i Komunës?

z. Kadri Krivenjeva: Kryesues, ky kuvend e ka një rregullore të punës, rregullorja duhet të respektohet, janë minutat e caktuar për pyetje dhe kërkesa.

z. Agim Çaka: 1. Disa persona të papërgjegjshëm edhe me tutje vazhdojnë të hedhin mbeturina të përroi i Çakëve, duke shkaktuar ndotjen e ambientit dhe pasqyrë jo të mirë për lagjen. Kërkoj të vendoset një shenjë për ndalimin e hedhjes së mbeturinave, dhe të merren masa ndëshkuese ndaj hedhësve të papërgjegjshëm, t'iu shqiptohen gjoba. Besoj se banorët e lagjes apo qytetarët e rastit kanë të drejtë me bërë foto dhe me i sjellë në komunë të inspektorati, për me iu shqiptuar gjoba.

2. Ka kohë që kam vërejtur një papërgjegjësi të strukturave komunale lidhur me flamurin shtetëror të rrethi i vogël, përballë gjimnazit. Ai flamur copë copa ka vleruar edhe në përvjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe po valon edhe sot. Respektimi i simboleve shtetërore është obligim i qytetarëve e në veçanti i strukturave udhëheqëse komunale, të cilët së paku dy herë në ditë kalojnë atypari (kryetari, nënkryetari, kryesuesi, drejtorët e drejtorive) e nuk e kanë vërejtur. Ai flamur në atë formë, paraqet një pamje jashtëzakonisht të turpshme në hyrje të qytetit, kështu që duhet të merren veprime të nevojshme me rregullua këtë çështje.

3. Kam një pyetje për parcelën në Koxhaj, e cila është votuar në kuvend, dhe është dërguar në shqyrtim të ligjshmërisë. A është kthyer përgjigje për këtë çështje, dhe për procedurat e mëtutjeshme?

z. Naim Beça: A ka mundësi në çdo mbledhje me pasur pikën: Të ndryshme? Përndryshe kur ne kemi ndonjë çështje, duhet me kërkuar me futur si pikë në rend të punës.

znj. Ardita Rrahani: Unë po i bashkohem Naimit, që në çdo mbledhje të KK, me pasur pikën: Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Pikë të ndryshme nuk kemi me pasur, ndërkaq kurdo që keni ndonjë problematikë, mundeni me kërkuar me debatuar në KK. Kemi pasur raste kur kemi futur në rend pune pikë të cilat janë kërkuar.

z. Naim Beça: Ne po e shfrytëzojmë pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave për çështjet që po na preokupojnë neve dhe popullatën tonë. Ne po kërkojmë ato çështje me i përmendur në këtë kuvend. KK është adresa ku mundemi me i ngritur këto çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Në KK diskutojmë për pikat që i kemi në rend dite dhe mund të kërkonim me futur në mbledhjen vijuese edhe çështje tjera të cilat iu preokupojnë. Përndryshe, ne me ardhur këtu me ngritur pikën të ndryshme, jemi pa përgatitur, dhe në fund nuk vendosim asgjë.

z. Naim Beça: Qytetarëve të komunës nuk iu interesojnë shumë raportet e punës, atyre iu intereson me pasur mirëqenie, siguri për fëmijët e tyre nga qentë endacak etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Në raportin financiar dhe në raportin e punës, është aktiviteti një vjeçar që është kryer. Aty mundeni me diskutuar për punët të cilat nuk janë kryer dhe arsyet. Ne për një temë të veçantë që është problematike në komunë, përpos që mundemi me futur në rend pune, mundemi me thirrur edhe mbledhje urgjente, se KK e ka këtë të drejtë, por jo me fol për tema të ndryshme, pa asnjë rezultat.

z. Naim Beça: Ne, për atë po i shfrytëzojmë seancat e KK me i ngritur çështjet që na preokupojnë.

z. Agim Mani: U krijua një parregullsi nga kolegët nga pozita, ndërkaq unë nuk e pashë se opozita ka dalë jashtë kornizave. Nëse e lexoni Ligjin për vetëqeverisje lokale, askush nuk ka të drejtë me ndërhy në diskutimin e tjetrit. Ne flasim për qytetarët, jo për delegatin. Kërkoj nga ju kryesues me mbajtur rendin e mbledhjes. Krejt këtë problem e shkaktoj Selajdini, kështu që duhet me ia tërhequr vërejtjen atij. Kërkesat janë të qytetarëve, nuk janë kërkesa tona, ata që nuk duan me dëgjuar, munden me dalë nga mbledhja.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në emër të grupit të LVV, shprehi ngushëllime të sinqerta familjes dhe komunitetit të aktrimit, për ndarjen nga jeta të Lulzim Rexha.

Kam një pyetje dhe një kritikë.1. Po debatohet që mos me ngritur pyetje, çështja është se ne duhet me ngritur pyetje për kërkesat të cilat i kemi ngritur në mbledhjen e kaluar, se nuk po kemi përgjigje. Unë kam bërë pyetje, ndërkaq drejtori i DUKMM nuk e ka kthyer përgjigjen.

2. Kam një shqetësim që faqja zyrtare e komunës së Kaçanikut, në facebook, mban një emër të shkruar gabim, Kacanik, në vend se të jetë Kaçanik. Një gabim i tillë, sado i vogël që duket, e dëmton seriozitetin dhe profesionalizmin e institucionit, duke dhënë një mesazh të pakujdesisë në përfaqësimin zyrtar. Faqja e një komune duhet të jetë model korrektesie jo vetëm në përmbajtje, por edhe në emërim, pasi është pasqyrë e imazhit të saj para qytetarëve dhe institucioneve tjera. Është urgjente që ky gabim të korrigjohet, për me u ruajtur standardet dhe dinjitetin institucional të komunës së Kaçanikut.

z. Rustem Zenuni: 1. Pyetje: Tani është bërë një vit që komuna e Kaçanikut ka aplikuar në nivel qendror në bazë të një thirrjeje nga ministria e Infrastrukturës me aplikuar komunat me projekte për investime kapitale. Një nga kërkesat e komunës së Kaçanikut ka qenë: Rehabilitimi i rrugës Bob -Dogonaj, pastaj rruga: Kaçanik i Vjetër-Begracë, rruga komandant Bardhi. A ka ndonjë përgjigje apo jo nga ministria në kërkesat komunës?

2. Një pyetje tjetër, është për drejtorinë e Arsimit: A keni ndonjë informacion për shkollën në Dogonaj, se është bërë e padurueshme gjendja e asaj shkolle, për me i dërguar nxënësit në atë shkollë? Kam edhe pyetje të tjera, por do t'i paraqes gjatë shqyrtimit të raportit të punës.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka. Nëse jeni të pajtimit e shqyrtojmë pikën 3 para pikës 2, për shkak të një takimi të drejtorit të drejtorisë. Meqë u pajtuan të gjithë, atëherë kalojmë në pikën e tretë:

3. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024;

E hapi diskutimin: Derisa të përgatiteni, fjalën ia jap drejtorit të DBF, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi: Pas mbledhjes se KPF, me kërkesën e arsyeshme të anëtarëve, ne e kemi dërguar edhe një material, Shpalosje shtesë për mjetet që janë shpenzuar. Gjatë vitit 2024, e

kemi filluar me buxhetin e miratuar, mbi 11 milion. Buxheti si çdo vit tjetër, ka pësuar ndryshime, mbi 13 milion nga bartja e mjeteve nga të HVK, 1 milion e 800 mijë euro, Granti i DEMOS për performancën e komunës, mbi 280 mijë euro. Krejt këto mjete që i kemi pasur në vitin 2024, i kemi shpenzuar në 12.1 milion. Granti qeveritar gjithmonë shpenzohet, se në të kundërtën shkon në deficit buxhetor. Mjete nga suficiti buxhetor nga Granti qeveritar është 1311 euro, ndërkaq pjesa tjetër e mjeteve të pashpenzuara janë nga të HVK, që është e drejtë me u bartë në buxhetin tjetër për shpenzim.

z. Agim Mani: Në raport janë paraqitur shifrat në saje të buxhetit, duke përfshirë buxhetin, të final dhe realizimin e tij. Raporti krijon mundësi për transparencë dhe përgjegjshmëri ndaj qytetarëve dhe duhet të pasqyroj me saktësi rrjedhjen financiare, ndarjen dhe kategorizimin e tyre si dhe realizimin konkret të projekteve. Sipas këtij raporti, komuna ka arritur ta finalizoj buxhetin në shumën mbi 13 milion euro në krahasim me buxhetin fillestar që ka qenë mbi 11 milion euro. Burimet kryesore të buxhetit janë: Granti qeveritar dhe të HVK. Komuna ka arritur me inkasua të HVK afër 1 milion euro. Komunës tonë i mbesin të HVK të pashpenzuara, këto mjete duhet të kthehen në investime kapitale, në zhvillimin e infrastrukturës, por ekzekutivi nuk ka arritur këto mjete me i kthyer të qytetari, por ka vepruar me një mendësi të njëjtë, që me i bartë vit pas viti. Të gjitha këto të HVK edhe të vitit tjetër, po bartën në vitin vijues. Komuna jonë i ka bartur në vitin 2025, mbi 1 milion euro, është shqetësuese bartja e këtyre mjeteve, duke ditur problemet që kanë qytetarët për çështje infrastrukturore, mjetet janë, por nga paafërsia dhe keq planifikimi i ekzekutivit, këto mjete nuk mund të realizohen. Deri tani u diskutua për shumë gropa nëpër rrugë të qytetit, për shumë nevoja të qytetarëve, ndërkaq ekzekutivi nuk ka arritur me i sanuar, ndërkaq mjetet janë të gatshme. Buxheti është shumë i vogël, përkundër kësaj, mjetet ngelin pa shpenzuar. Në bazë të këtij raporti, 12 milion euro janë realizuar, ndërkaq mbi 1 milion euro bartën në vitin vijues. Janë paraqitur në formë tabele, shpenzimet e kategorizuara, është shqetësuese fakti po ndërlidhet me krejt ato pyetjet kur e përmenda mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rurale. Të mirëmbajtja e rrugëve, nga raporti financiar 9 muaj, janë shpenzuar 230 mijë euro, ndërsa në raportin vjetor, 250 mijë euro. Kjo i bien që për 9 muaj 230 mijë euro, ndërkaq për 3 muaj vetëm 20 mijë euro. Kjo i bien se nuk keni interesim t'i mirëmbani rrugët. Shpenzimet e gjykatave janë mbi 600 mijë euro, nga shpenzimet komunale, kapitalet, mallrat dhe shërbimet. Të Investimet kapitale janë paraqitur 4 milion e 321 mijë euro, për mua është e paqartë që realizimi është 3 milion e 436 mijë euro. Këtë pyetje e kam bërë në KPF, kam kërkuar me ditur, a shpenzuar kjo shumë e mjeteve mbi 3 milion euro? Përgjigja ka qenë, po. Nëse janë shpenzuar 3 milion euro për IK, përmbaruesi ia ka marrë 511 mijë euro nga IK, mbetja për IK është 840 mijë euro. Nëse janë realizuar 3 milion e 436 mijë euro, +511 mijë euro për gjykata, i bien se mbetja e mjeteve është shumë e vogël. Në bazë të këtij tabele, nuk figuro gjobat e gjykatave nga IK. Është mirë kjo të sqarohet.

z. Bahri Selimi: Të HVK u përmend se komuna nuk i shpenzon për IK. Nga 980 mijë të inkasuara, janë shpenzuar afërsisht 700 mijë euro për IK. Të hyrat nga TP dhe ato nga lejet e ndërtimore, të gjitha alokohen me destinim për IK, qytetarit i kthehen në shërbime publike, si kanalizim, ujësjellës etj. Të HVK nuk mundem me i shpenzuar asnjëherë krejt, për shkak se inkasimi i atyre në tetor-dhjetor, është i pamenduar me u shpenzuar kur janë inkasuar. Inkasimi ndodhë, qytetarët e paguajnë si TP, pagesat me të mëdha janë këtu, se qytetarët paguajnë tatimin për një vit.

z. Agim Mani: Të HVK ju po thoni se i keni shpenzuar 770 mijë euro, nga raporti thuhet se 980 mijë euro janë të HVK të inkasuara, janë realizuar mbi 1 milion euro, apo 20-30 mijë euro me tepër se planifikimi. A ka nga këto mjete që nuk kanë mundur me u realizuar në vitin 2023?

z. Bahri Selimi: Çdo vit ka dhe do të ketë të HVK nga viti paraprak, se nuk mundem me u shpenzuar mjetet deri me 31 dhjetor, sepse gati se me 31 dhjetor i ndalim procedurat e tenderimit, ndërkaq kryhen vetëm obligimet. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale, është drejtori Ramadush për sqarime. Shpenzimet e gjykatave, kontrata kolektive është ende aktive,

obligimet janë të mëdha për komunën, ka pasur pyetje se mos po rastësisht po falimenton komuna nga këto obligime. I kemi mbi 2 milion euro obligime nëse shkojnë me përmbarues. Ne jemi munduar disa me i kryer në vitin e kaluar, me iu ikur shpenzimeve përmbarimore. Janë arritur disa marrëveshje mes gjykatës, avokatëve dhe komunës. Janë kryer obligime ndaj arsimtarëve diku gjysmë milioni euro, edhe sivjet do të mundohemi me kryer obligime aq sa mundem, por për disa që kanë shkuar në apel, janë procedura tjera, ato tjerat që vijnë janë me kosto të plota me shpenzime administrative, përmbarimore etj. Të projektet kapitale nuk lëvizë asnjë cent, i kemi pasur mbi 4 milion, janë shpenzuar mbi 3.4 milion, kanë mbetur 840 mijë euro pa shpenzuar. Brenda shumës 3.4 milion euro që janë shpenzuar në vitin 2024, 511 mijë nuk kanë shkuar të ato projekte në realizim, për shpenzim gjykate, por nga kodi i atij projekti, dhe ne nuk mundem me tjetërsuar. Mjetet janë marrë nga ai projekt dhe del si shpenzim i atij projekti, pagesa nuk është për operator ekonomik, por për shpenzim të gjykatës. Ne Ekzekutivi bëjmë disa politika si komunë me i mbuluar ato shpenzime, por mos me i rrezikuar aktivitet tjera. Në vitin 2024 ka funksionuar mirë, janë paguar rryma, ujë, mbeturinat, i kanë marrë mjetet punëtorët, nuk kemi pasur asnjë problem si komunat tjera që nuk iu kanë dalë pagat, i kemi kryer obligimet e gjykatave, pa i rrezikuar obligimet tjera rrjedhëse. Të IK nuk ka plus 511 mijë euro, por ka brenda shpenzimit të paraqitur si në tabelë, përfshirë pagesat ndaj gjykatave. Tani i kemi kryer disa shpenzime të gjykatave të kategorive tjera, por që janë më pak, nuk janë materiale.

Kryesuesi i Kuvendit: Rregullat i din Agim, përmbaju rregullave, i keni 2 minuta replikë.

z. Agim Mani: Duhet me sqaruar, se është e pakuptueshme kjo që e tha drejtori. Nëse ju e keni ofruar këtë formë tabele dhe nuk e keni paraqitur askund gjë e gjykatës 511 mijë euro, në bazë të këtyre llogaritjeve iu kanë dalë 3 milion e 400 mijë euro. Nëse i heqim minus 511 mijë euro nga këto, i bien që IK janë realizuar 2 milion e 900 mijë euro. Kështu duhet me njoftuar qytetarin, se qytetari nuk e din, jeni munduar me i fshehë nëpër këto rubrika, kur i kam llogaritur krejt këto, ka dal në tabelë shuma e gabuar. E dyta, të gjykatat, të MSH, 108 mijë euro i janë paguar gjykatës. A nuk është shqetësuese kjo që paratë e qytetarëve me i paguar në damë të komunës, kurse në anën tjetër 22 mijë euro keni paguar shërbime këshilluese për mos me gabuar ju si ekzekutiv, në anën tjetër i paguani gjykatave.

z. Bahri Selimi: Gjithë atë material shtesë që ju kemi dërguar, fillon me u keqpërdorë prej Agimit. Kontrata kolektive për arsim, është obligim qeveritar. Agimi na akuzon pse ne i paguajmë ato mjete. Në shumë raste na i tërheqë thesari, na i tërheqë ministria e Financave, për obligimet e veta.

z. Rustem Zenuni: Drejtor, atë nuk bënë me ditur qytetari, vetëm këta duhet me ditur.

Kryesuesi i Kuvendit: Kush donë me marrë fjalën, e ngritë dorën e fol.

z. Bahri Selimi: E kuptoj që ne duhet me nxjerrë shifra, për me qenë me të qartë, në raportin bazik është e shpalosur sesa mjete janë marrë dhe ku janë marrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Është një kontratë që iu ka shkaktuar probleme komunave të Kosovës. për me i mbuluar shpenzimet. Këto janë obligime ligjore që duhet me i përmbushur, janë të drejta të mësimdhënësve që iu takojnë me ligj. Vendimet janë të gjykatave dhe janë përfundimtare, kështu që nuk kemi çka me u lëshuar në këtë debat, se vendimet janë të formës së prerë. Pasi po kërkon rend dhe rregull, të mësohemi të respektojmë rendin në mbledhje.

z. Rustem Zenuni: Kryesues, jeni duke diskriminuar neve në këtë pjesë, për dhënien e fjalës. Sa i përket raportit financiar, për neve jemi me fat që drejtori është profesionist, asnjëherë nuk e ka sjellë komunën në gjendje financiare, si disa komuna tjera. Ku qeverisë PDK, ka rregull, ka llogari. Sot komuna ka paguar gjë gjykatës, është mirë me ua sqaruar qytetarëve se nuk është gabimi jonë, është gabimi i njerëzve të gabuar në një vend të caktuar, si ministria e arsimit. Me mirë do ishte këto mjete t'i orientojmë në investim kapital, sesa për gabimet e njerëzve të pa duhur atje, me na i marrë me gjykatë. Këtë është mirë me sqaruar dhe është mirë

që u potencua. Sa i përket raportit financiar, mendoj se nganjëherë po ju hymë në hak, se e meritoni me qenë në një nivel tjetër me qeverisë, e jo në Kaçanik.

z. Bashkim Luma: Të çështja e të HVK të pashpenzuara, desha me i thënë drejtorit se nuk pajtohem me faktin që nuk shpenzohen të gjitha mjetet, me arsyetim së të HVK inkasohen edhe në muajt e fundit. Nëse bazohemi në atë, atëherë të HVK të vitit 2023 kanë qenë 1 milion e 92 mijë, shpenzime 1 milion e 98 mijë euro, është tejkaluar shpenzimi për kah aspekti i bartjes nga viti i kaluar. Në vitin 2024 të HVK janë 980 mijë euro, bartja 1 milion 98 mijë euro, shpenzimi është 1 milion e 32 mijë euro.

z. Bahri Selimi: Për nivelin qendror GQ është si të ne të HVK ato i kanë të hyrat të veta. A është planifikuar në vitin 2024 projekti, ndërtimi i SHFMU “Emin Duraku”? A janë shpenzuar ndonjë mjet, ku janë mjetet? Janë të planifikuara, të buxhetuara mjetet, ndërkaq shpenzimi është 0, njëjtë si të ne, planifikimi bëhet, por realizimi nuk bëhet 100%.

z. Bashkim Luma: Përse në vitin 2023 ka pasur me shumë shpenzime edhe pse bartja ka qenë me e vogël sesa në vitin 2024?

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është se komuna e ka ditur për obligimet në kontratë kolektive se janë në procedurë përmbarimore. Ndoshta janë marrë mjetet në ndonjë projekt me pak i rëndësishëm për mbulimin e kostos, për mos me u prekur ndonjë projekt me i rëndësishëm, dhe është shumë normale kjo.

z. Bashkim Luma: Pajtohem me këtë pjesë, kjo është temë tjetër, por drejtori si duket është i kënaqur kur po thotë se ne po e shpenzojmë krejt grantin qeveritar. Të HVK duhet me i shpenzuar drejtor, se qytetarët kanë nevojë për këtë shpenzim të mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit: Të HVK kanë mundësi me u ridestinuuar me i shpenzuar diku ku ka nevojë me tepër.

z. Bahri Selimi: Granti qeveritar e kemi në dispozicion, i zotojmë mjetet për shpenzim, ndërkaq të HVK nuk mundem me i shpenzuar pa i inkasuar. Presim të mblidhen në fund të vitit, pastaj me i shpenzuar.

z. Bashkim Luma: Të HVK të bartura nga viti i kaluar janë 1 milion e 98 mijë euro, ndërsa bilanci për bartje tani është 1 milion e 32 mijë euro, që i bien shuma e shpenzuar për vitin aktual është 1 milion 45 mijë euro, 50 mijë euro janë të pashpenzuara, të cilat kanë qenë në dispozicion.

z. Bahri Selimi: Nuk janë shpenzuar këtu vetëm të HVK të vitit 2024, janë edhe ato të vitit 2023 që janë bartur në vitin 2024. Ato mjete bëhen bashkë dhe nuk ka rëndësi nga kanë ardhur, ato janë të HVK, e marrin njëfarë kodi bëhen 22, ndërsa 21 janë të këtij viti.

z. Bashkim Luma: Nuk pajtohem me faktin që thoni se deri në fund të vitit nuk i marrim të HVK, se në këtë rast ne kemi të HVK, me tepër, ndërkaq shpenzimi është me i vogël.

z. Bahri Selimi: Po, kjo qëndron.

z. Naim Beça: Asnjë nga ne nuk dyshon në profesionalizmin e drejtorit të financave, por gabimet bëhen. Ne si parti opozitare jemi duke i pa gabimet dhe i kemi evidentuar. Qëllimi ynë drejtor është që të HVK me u shpenzuar me tepër, e jo me u shpenzuar pas 1 apo 2 viteve. Pyetje: A mundeni me shpenzuar në vitin 2025 me tepër - në minus, pastaj kur të mblidhen të HVK, me u barazua?

z. Bahri Selimi: Me ligjin e menaxhimit të financave publike, nuk lejohet me shpenzuar mjete në minus. Lejohet marrja e ndonjë kredie nga bankat botërore, por jo me shpenzuar në minus, se është parimi i KESh, nëse nuk kemi fonde në dispozicion, nuk mundesh me bërë pagesë.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Edhe për ne drejtor paraqesin shqetësim të HVK, ka shumë të hyra vetanake të pashpenzuara dhe të bartura nga viti 2024 në vitin 2025. Arsyeja vjen për

shkak të kontratës kolektive, por është një shumë e madhe e mjeteve që bartët në vitin vijues, e theksoj edhe Bashkimi këtë çështje, po e theksoj edhe unë, se e pata të shënuar me theksuar.

z. Bahri Selimi: Një nga arsyet që mbetin të pasqepzuara të HVK, ne për secilin projekt bëjmë planifikimin. Nëse projekti kushton 100 mijë euro, 80 mijë euro planifikohen nga GQ, ndërkaq 20 mijë nga të HVK, mbi 100 mijë euro nuk mundet me u dhënë tenderi. Nëse kontrata është arritur me 90 mijë euro, shpenzohen mjetet nga GQ dhe 50% të HVK nga ato të planifikuara për atë projekt. Shuma 10 mijë euro janë kursime nga projekti, dhe këto mjete automatikisht mbetin të pasqepzuara. Po të ishit edhe ju në vendin tonë, me përpara i kishit shpenzuar mjetet nga GQ sesa të HVK, për shkak të fleksibilitetit që e kanë të HVK me u bartur, ndërkaq mjetet nga GQ nuk mundet me u bartur.

z. Bashkim Krasniqi: Po ndërlidhem me diskutimin e kolegëve. Nuk e di pse nuk i japim mirënjohje drejtorit që e ka shpenzuar GQ 99.9%. Të HVK kanë mbetur pa shpenzuar, ato mjete nuk humbin, barten në vitin vijues për shpenzim në ndonjë projekt. Komuna nuk humb asgjë në këtë drejtim, drejtori pa ua sqaron se të HVK nuk mund të shpenzohen asnjëherë të gjitha brenda periudhës që mbledhen. Unë nuk e di, a jeni duke pasur dëshirë me ngelur mjete nga GQ me u kthyer në qeveri, e ne e dimë se ku i shpenzon qeveria nëse kthehen mjetet nga GQ. Qytetarit nuk i intereson nga cilat mjete realizohen projektet, i intereson që komuna mos me kthyer mjete në qeveri. Të HVK bartën, kjo është normale dhe shpenzohen në vitin vijues në ndonjë projekt me të madh. Ju po keni dëshirë vetëm me bërë lojëra, pse kjo kështu apo ashtu. Për me i kuptuar disa gjëra, ndoshta duhet me qenë ekonomist, nuk është këtu as kurs me iu treguar juve sesi bëhen numrat, janë do kushte, shkoni i lexoni i kuptoni, e jo pse kjo kështu apo ashtu.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Po ne kemi të drejtë me pyetur Bashkim.

z. Bashkim Krasniqi: Keni të drejtë me pyetur, por jo me kërkuar pse kjo është bërë kështu apo ashtu.

z. Agim Çaka: Kam fjalë të mira për drejtorin për hartimin e raportit në formë shumë të mirë, por kjo nuk do të thotë se raporti është hartuar mirë dhe puna në terren është mirë. Mjetet arsyetohen me punët që janë bërë në terren. Raporti financiar paraqet një barazim të shifrave të shpenzimeve të buxhetit të komunës. Raporti mund të jetë korrekt sa i përket shifrave, mirëpo punët në terren dhe zhvillimi i komunës është e kundërta dhe nuk i arsyetojnë shpenzimet e buxhetit. Shpenzimi i buxhetit është në proporcion të zhdrejtë me kualitetin e punëve dhe zhvillimin e komunës në të gjitha fushat. Raporti është krejt në rregull, barazohen shifrat, hyrjet daljet buxhetore, se mos me u barazua, drejtori nuk mundet me qëndruar në atë pozitë, por çështja është se shpenzimet janë duke u bërë, por puna në terren nuk është mirë. Në çdo mbledhje po ngritën shqetësime rreth atyre punëve në terren që janë realizuar me buxhetin e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e vërtetë ajo që thoni Agim, se të hyrat buxhetore duhet me qenë në raport me shpenzimet, këtu shumë herë po debatohet, debatohet për mospërputhje të shifrave. Raporti i nënshtrohet auditimit, auditori na tregon se ku ka gabuar komuna. Nëse nuk përputhen shifrat, auditori nuk e pranon fare raportin. Nuk kemi pasur probleme me auditimin e raportit financiar nga auditori. Ka të gjetura që i jep auditori, por jo në mospërputhje të shifrave, janë të punët në terren që po i përmend Agimi, ose në procedurat e zhvillimit të tyre. Nga ky raport, shpenzimi i të hyrave të GQ varët granti i performancës, që ne ka vite jemi fitues në saje të shpenzimit të këtij buxheti nga GQ. Të HVK bartën nga viti në vit, shpenzohen në vitin vijues, me miratim të KK. Sa i përket saktësisë apo pasaktësisë së shifrave të paraqitura, mos u shqetësoni për këtë çështje, se bëhet auditimi i raportit.

z. Ramadush Osmani: Agimi e potencoj çështjen e mjeteve për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rurale. Mirëmbajtja investuese çdo vit ka me ardhur duke u ngritur, për shkak të investimeve që bëhen, ato duhet të mirëmbahen. Të kodi, mirëmbajtja e rrugëve lokale, shuma, 152 mijë e 429euro, janë tre kontrata. Është mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve,

mirëmbajtja e ndriçimit publik, 214, 283 euro, mirëmbajtja e ndriçimit publik, mbi 27 mijë euro, kontrata aktive, mirëmbajtja dhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal. A ka nevojë për dritë, rrugët me gropa, po ka nevojë se rrugët. Bartja me pesha të rënda të automjeteve, që u potencua rruga e Runjevë, rruga që është dëmtuar nga punë kryesi për realizimin e linjës hekurudhore, inspektorati ka raport, ia ka dorëzuar kompanisë punë kryese për rehabilitimin e saj dhe do të kthejë në gjendjen e mëparshme. Këto dëmtime që janë bërë, jemi duke i riparuar. Në raportin e punës i keni dy pozicione të mirëmbajtjes, largimi i borës dhe hedhja e kripës industriale për gjitha rrugët, 247 km mirëmbahen, janë 21 aktivitete të mirëmbajtjes vjeshtore dhe verore, ka nevojë edhe me tepër për mirëmbajtje. E kemi edhe mirëmbajtjen rutinë, përfshihen mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, largimi i deponive ilegale nga DUKMM, në atë shumën e potencuar. Nëse flasim për të HVK, unë merrem me projekte, shumica e kontratave lidhen nën buxhetin e planifikuar. Unë vetëm 11 cent i kam pashpenzuar nga GQ, prej gjysmë milioni, pjesa tjetër, bartët vit pas viti dhe ridestinohet. Janë të shënuara sa janë shpenzuar në kodin 21, sa në kodin 22, për shkak se kontrata ta imponon pjesa tjetër me mbetur, dhe nuk mundesh këtë pjesën tjetër me hapur tender në tetor, me procedura nuk mundesh me i shpenzuar, pa e mbyllur kontratën paraprake.

znj. Ardita Rrahmani: E potencuan edhe kolegët se buxheti është realizuar nga GQ, kjo është me u përshëndetur. Çështja është se kërkesat tona duhet me u elaboruar, që ato mjete me shkuar në vendin e duhur, e mos me u kthyer në deficit buxhetor, por me i orientuar ku duhet.

z. Bashkim Krasniqi: Ju kur të bëni kërkesa, ato duhet me u realizuar me buxhet, e ju atë buxhet nuk e keni votuar. Kryetari i ka do premtime që i ka premtuar gjatë fushatës dhe donë me i realizuar. Ju (Ardita) e keni pasur një kërkesë, por janë edhe 100 kërkesa tjera. U përmend rehabilitimi i rrugës Bob- Doganaj nga kolegu, kjo ka qenë në prioritet, por ju nuk e keni votuar. Nuk e keni votuar as projektin që ka qenë në buxhet, rruga: Kaçanik-Kaçanik i Vjetër. Ju bëni kërkesa, ndërkaq buxhetin nuk e aprovon. Atëherë, si mendoni ju me i realizuar ato kërkesa?

znj. Ardita Rrahmani: Po e marrë të drejtën e replikës, pasi më është përmendur emri. Si Arditë dhe si LDK kemi marrë pjesë këtu e në debate publike që janë për qytetarët. Ne i kemi paraqitur kërkesat tona si anëtarë të KK, por nuk janë marrë parasysh. Pse unë me votuar buxhetin, kur ju nuk i jepni prioritet kërkesave tona. Cila është logjika e kësaj? Edhe në debate publike kam marrë pjesë në cilësi të qytetarit, i kam paraqitur kërkesat, janë procesverbalet, kanë qenë kryetari, nënkryetari, kryesuesi, ndërkaq ju (Bashkim Krasniqi) nuk keni qenë prezentë, ndërkaq mua me thoni nuk e keni votuar buxhetin. Ku është logjika që prioritetet e juaja me i votuar unë.

z. Bashkim Luma: Mendoj se shtojcat që po vijnë të raportet tre-katër ditë pasi na ka ardhur materiali, kjo është e paarsyeshme, gjë që po ndikon në mungesën e plotë të informacionit. Ka pasur raste kur drejtori në muajin mars na ka dërguar si lloj shtesë në email të Agimit, pastaj po na akuzoni, që nuk kemi informacion, ose po mundoheni me keqinterpretuar atë që ne po e lexojmë në raporte.

E dyta, Për drejtorin Ramadush, ne e kemi pa që janë tre kontrata, por gjendja në terren lënë shumë për të dëshiruar. Është rruga në Strazhë, nga magjistrallja, që nuk është e mirëmbajtur, kontrata vazhdon, pagesat bëhen. Rruga e Strazhës nga magjistrallja deri në fund, nuk ka as mirëmbajtje verore, ndërkaq dimërore ka. Mirëmbajtje vjeshtore sidomos jo vetëm të rruga e Strazhës, por edhe të disa rrugë tjera, nuk kanë. Kur bien shi, gurrëzat që bien në rrugë, nuk pastrohen. Edhe defektet që po shkaktohen kohë pas kohe në rrugë, nuk po pastrohen.

z. Betim Shala: Po ndërlidhem me diskutimin e Bashkim Krasniqit, që e potencoj se nuk e kemi votuar rrugën: Kaçanik-Kaçanik i Vjetër. Ne nëse nuk e votojmë buxhetin, nuk do të thotë se jemi kundër një rruge. Ka shumë rrugë e kanalizime të lagjeve me shumë banorë që kundërmojnë, që janë të nevojshme me u realizuar, e nuk kanë hyrë në buxhet. Qysh me votuar

atëherë në buxhetin. Ne nuk jemi kundër asnjë projekti, por çështja është se duhet me u specifikuar projektet.

z. Ramadush Osmani: Mirëmbajtja e rrugës: Gajre, Ivajë-Strazhë, e ka koston me të madhe dimrit. Ka ndodhur 5 herë në ditë me u mirëmbajtur për shkak të konfiguracionit, kompania e ka 50 euro km. me pastruar. Në këtë rrugë ka shumë ortekë, rrëshqitje që e nxënë rrugën për automjete. Dy pozicione janë në 2024, ku shkruan, Largimi i prurjeve nga vërshimet, të përroi i f. Gajre. Ne e dimë pozicionin e rrugës, tani fillon pjesa e mirëmbajtës verore, rigolla që është mbushur me gurë. Janë pozicionet që kemi intervenuar, ndërkaq lënë me dëshiruar puna në terren dhe sa na lejon kontrata.

z. Bashkim Luma: Drejtor, në atë rrugë nuk është vetëm një pozicion, ajo rrugë është e gjatë dhe pastrimi i vetëm të një pozicioni, është e pamjaftueshme.

z. Selajdin Troni: Kam një pyetje për drejtorin e DSHPE, Ramadush Osmani: Në KK e kemi marrë një vendim për subvencionimin e rasteve mortore për qytetarët e komunës së Kaçanikut. Në vitin 2024 janë shpenzuar 35,775 euro. A janë të njoftuar qytetarët se krejt shpenzimet për raste mortore i mbulon komuna e Kaçanikut, se ka qarkullua një çështje se BIK e ka marrë një vendim për ngritjen e tarifave të anëtarësisë nga 5 në 7 euro, me 2 euro ngritje të anëtarësisë, me u mbuluar shpenzimet për rastet mortore. Duhet me i thënë edhe BIK që mos me bërë propagandë, me iu thënë se, më shumë 300 euro mbulohen nga komuna të gjitha shërbimet për rastet mortore të qytetarëve të komunës së Kaçanikut, e jo prej BIK, ndërkaq BIK lë të sqaron vendimin e tij për çka e ka marrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Është çështje me vend Selajdin, se kjo që e potencove, ka qarkulluar shumë në opinion, mirë që e ngrite si temë.

znj. Ardita Rrahmani: Para dy mbledhjeve e kemi diskutuar punën e anëtarësisë së BIK dhe punës e shërbimeve mortore.

z. Ramadush Osmani: DSHPE i mbulon me subvencione shpenzimet mortore në komunën e Kaçanikut, në bazë të marrëveshjes që ka rrjedhë nga vendimi i KK. Deri në vitin 2024, ka qenë 175 euro shuma për një rast mortor, plus 175 euro janë shtuar për veteran, për shkak të dy aktiviteteve tjera. Nga viti 2025, janë shpenzimet me të mëdha, për shkak se kryhet edhe shërbimi, hapja dhe mbulimi i varrit. Në vendim është cekur tekstualisht se komuna mbulon të gjitha rastet mortore dhe të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me një rast mortor: temxhiti, sigurimi i dërrasave, qefini, larja, ceremonia fetare, hapja dhe mbulimi i varrit, transporti, piramida, që nënkupton që qytetari që ka rast mortor, të gjitha shërbimet ia mbulon komuna. Me marrjen e këtij vendimi, është shënuar, se BIK me ia kryer këtë shërbim qytetarit, nuk mundet ta kushtëzoj qytetarin me anëtarësi, por edhe qytetarin nuk e liron nga anëtarësia e pagesës për aktivitete tjera të BIK. Nëse është propaganduar në opinion, se rasti i ngritjes së anëtarësisë ndërlidhet me hapjen e varrit, kjo nuk qëndron. Aktivitetet tjera ekonomike, jeta e shtrenjtë që imamët i ndërlidhë me pagë, kjo është diçka tjetër. Tani kemi me pasur fatura me të larta, 300 euro është për një rast mortor, ndërkaq për veteran i shtohen plus 175 euro tjera. Rasti i veteranit 475 euro. Gjatë një viti, ka mundësi me pasur diku 200-220 raste mortore, në bazë të specifikave që kemi.

znj. Arlinda Raka-Rakoci: Duhet me ia sqaruar ju këtë çështje me BIK-ut, se janë 2 raste që unë i njoh që BIK nuk kanë dashur me ia kryer ceremoninë e varrimit, për shkak të mos pagesës së anëtarësisë.

z. Ramadush Osmani: Unë nuk kam çka me ia sqaruar, BIK e obligon marrëveshja e lidhur me komunën.

Kryesuesi i Kuvendit: Realisht është e kundërligjshme ajo dhe jo njerëzore, për shkak se komuna ju e dini mirë, kur ne nuk i kryenim shërbime qytetarëve që nuk i paguanin TP, edhe atë na e hoqën. Ne jemi institucion, por nuk na kanë lejuar atë formën e kushtëzimit, sepse ka

forma tjera të autorizuar për mbledhjen e borxhit, janë gjykatat, përmbaruesit. Kushtëzimi nuk guxon me vlejtur për shërbimet. Meqë janë të mbuluara të gjitha shërbimet mortore nga komuna, BIK nuk ka të drejtë me u thirrur në anëtarësi për me i kryer shërbimet. Ata duhet me gjetur forma tjera për me i inkasuar anëtarësinë. Është mirë drejtor me sqaruar këtë çështje me përfaqësuesit e BIK në ndonjë takim, në mënyrë që kjo çështje mos të interpretohet në opinion, se ngritja e anëtarësisë nga BIK është bërë për shkak të shtimit të shërbimeve mortore, sepse të gjitha shërbimet mortore i mbulon komuna.

znj. Ardita Rrahmani: Mendoj se është mirë me bërë një Njoftim lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Besoj se duhet me u marrë me këtë çështje, se është keqinterpretuar shumë në opinion.

znj. Kadrije Lika-Troni: Desha me pyetur drejtorin, A ka ndonjë raport mujor, se është bërë një muaj nga kur ka filluar marrëveshja me BIK. A ka pasur kosto që komunës i ka shkaktuar pak damë dhe a është duke u parë si i mirë ky vendim që është marrë? Pajtohem me Arlindën për dy ankesat të cilat i potencoj, pas hyrjes në fuqi të vendimit të KK, se është shqetësuese kjo. Ju si drejtor, duhet me dal me një njoftim, me bërë me të qartë këtë çështje për qytetarët.

z. Ramadush Osmani: Planifikimi buxhetor ka qenë 60 mijë euro për vitin 2024. Edhe atëherë kemi menduar se kemi mundësi buxhetore me përballuar edhe hapjen e varrit, mirëpo edhe BIK nuk ka qenë i gatshëm në aspektin e implementimit të këtij shërbimi. Mjetet për subvencione që i kam në drejtori, mendoj se janë të mjaftueshme (nuk e dimë sa raste kanë me ndodhur) e shohim të përmallueshme me i mbuluar këto shërbime, në të kundërtën ka subvencione tjera që e mbulojnë. Raport mujor kemi çdo muaj që na e sjell BIK për rastet që kanë ndodhur, nuk po kemi problem buxhetor me i mbuluar, e kemi planifikimin e këtyre shpenzimeve, por BIK është duke pasur problem në terren në implementim të saj, ndërkaq neve na intereson me iu kryer shërbimi qytetarëve, neve na vjen si shërbim që është kryer. BIK i ka punëtorët e tij dhe imamët në terren, është çështje e secilit imam që nganjëherë del prej vetvetes për me arritur pjesën e inkasimit, por padrejtësisht dhe jo me këtë vendim, jo me këto shërbime, por BIK duhet me gjetur forma tjera me mbledhë anëtarësinë, por edhe ne të besimit islam e kemi obligim me kryer anëtarësinë, se ata marrin paga dhe i mirëmbajnë xhamitë nga anëtarësitë e qytetarëve.

z. Ekrem Livoreka: Faleminderit shumë drejtor që e sqarove këtë çështje për publikun, se shumica e qytetarëve mendojnë se edhe BIK participon në këtë shumë, kështu që qytetarët kanë pasur arsye me menduar ndryshe, kur BIK e ka ngritur anëtarësinë. Sa i përket pagave të BIK, ne nuk mundemi me iu ndihmuar, ndërkaq ne po sqarohemi se jemi në rregull si komunë për shërbimet mortore që i mbulojmë.

z. Burim Shehu: Desha me qartësuar një pyetje që e kam. Për mërgimtarët a mbulohen shpenzimet e varrimit?

Kryesuesi i Kuvendit: Për qytetarët e komunës së Kaçanikut mbulohen të gjitha, vetëm me sjellë kufomën nga jashtë, jo.

z. Ramadush Osmani: Transportin e mbulon komuna nga aeroporti.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024/Lënda: 01Nr. 400/01-3950/25.

3. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Meqë raporti i ekzekutivit është i lidhur me buxhetin e komunës, është i ngjashëm me raportin financiar, sepse shpenzimet bëhen nga buxheti. Raporti paraqet një pasqyrë të qartë se është në përputhje të plotë me buxhetin dhe planin e ekzekutivit. Nëse e analizojmë raportin e ekzekutivit, dalin në pah edhe parregullsitë, del në pah edhe planifikimi që është bërë me herët. Kolegu ynë kur e potencoj se nuk e keni votuar rrugën: Runjevë-Stagovë, me buxhet është paraparë ky projekt, në raport të ekzekutivit nuk figuron, kjo rrugë nuk është kryer. Nuk e di procedurat pse ka dështuar ky projekt. Nëse shikojmë raportin e prokurimit, e jep qartë se janë lidhur 82 kontrata, 19 prej tyre janë anuluar, 5 lëndë janë në OSHP dhe 3 lëndë janë në procedurë e sipër. Shqetësuese është fakti i anulimit të 19 kontratave, se kanë mbetur pa u realizuar 19 projekte. Është paraqitur një pasqyrë e qartë e realizimit të projekteve në secilën drejtori, ndërkaq a janë realizuar në bazë të prioritetëve të qytetarëve apo jo, ajo është diçka tjetër, këto janë realizuar në bazë të prioritetëve që i ka dhënë ekzekutivi. Raporti në përmbajtje i ka saktësuar të gjitha punët që i ka kryer ekzekutivi, por është shqetësuese se nuk janë prioritet të qytetarëve, sepse kemi shumë rrugë të cilat janë dashur me u asfaltuar e nuk janë asfaltuar, apo shumë projekte tjera që është dashur me u kryer me prioritet e nuk janë kryer. Që dy mandate jam anëtar i KK, kam propozuar projekte, por ju projektet i orientoni nga është ekzekutivi dhe nga i keni përkrahësit e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti është një pasqyrë e përgjithshme e Ekzekutivit, i cili rrjedhimisht duhet me u krahasuar me planin e tij të punës. Janë do çështje që ndikojnë në mosrealizim, si çështja e anës financiare, kontrata kolektive, vendimet e gjykatave, se është dashur me u anuluar disa aktivitete për shkak të pagesave të detyrueshme. Kontratat e anuluar, prokurimi ka planifikuar shumë kontrata, por disa janë anuluar për shkak të kostos buxhetore, se është dashur me ndarë për kontratën kolektive, disa për shkak të mosplotësimit të kushteve të operatorëve etj. Raporti është paraqitur saktë në vija të trasha, për punën njëvjeçare të ekzekutivit.

z. Rustem Zenuni: Në raport ka shumë punë të mira që janë bërë. Është hedhur shumë mllef e të pavërteta këtu, për me informuar gabim qytetarët e komunës. Përkundër kësaj, sa salla sporti janë realizuar, sa rrugë lokale, shtylla elektrike, kanalizim, ndriçim publik. Nuk është e vërtetë që projektet shkojnë kah janë përfaqësuesit e partisë në pushtet, por po mundohet me keq informuar opinionin. Ne i kemi shkruar deputetit të LVV për prioritet, por nuk ka sjellë as “dy kaci zallë”, ndërkaq ne e kemi shtruar rrugën. Është komplet ndriçimi publik në një rrugë në Stagovë, nuk bënë me ia humbur mundin Ekzekutivit, mbi 370 mijë shërbime në QKMF, është turp me humbur mundin e komunës, sa investimet janë bërë në shkollë. Ne e kemi një shkollë në Doganaj, ne e dimë në çfarë gjendje është, ndërkaq shtohet pyetja, çka kanë bërë kolegët tuaj të LVV për Kaçanikun?

z. Agim Mani: Ndriçimi publik në Stagovë, me metra është realizuar, jo në km.

znj. Ernesta Krasniqi: Kryesues, tërheqja vërejtjen Rustemit. Me tregoni, çka ke bërë ti për Kaçanikun Rustem?

z. Naim Beça: Kryesues, a jeni duke dëgjuar se çka është duke thënë?

Kryesuesi i Kuvendit: Secili e ka mendimin e vet se çka fol, askush nuk mundet tjetrit me ia imponuar debatin se çka fol. Rustem ndërprerje fjalën, mos fol fjalë që nuk duhet me fol.

nj. Florina Lika-Vishi: Falënderoj ekzekutivin për gjithë punën e bërë me stafin që e kanë në kabinetet e tyre. E kam një shqetësim: Çështja e ujit të pijes. E di se keni bërë një investim të madh për ujin, tani kjo çështje ka kaluar në menaxhim të kompanisë “Bifurkacioni”. Jemi dëshmitarë se në vitin e kaluar kemi hasur në shumë probleme sa përket ujit të pijes. Dua të di: A është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, që vera mos të na nxënë pa përgatitur? Lagjja nga vijë unë- lagjja Vishi, edhe në këtë kohë të ftohët dimri, jemi ballafaquar me problemin e

ujit. Ku është problemi, përderisa ujin e paguajmë, ujë nuk kemi, a është puna e menaxhimit apo çka po ndodhë? Në seancën vijuese, kërkoj të ftohen në kuvend për interpelancë përgjegjësit e ujit të pijes. Lë të jetë si pikë e veçantë në kuvend, Çështja e ujit të pijes. Përderisa kompania nuk po ofron zgjidhje, komuniteti e ka për obligim me ditur problemin.

znj. Ardita Rrahmani: E kam një kritikë për mos qasje e kamerave në incizim të kësaj mbledhje, pavarësisht problemeve, se ka qytetarë që po na shkruajnë.

z. Bejtulla Dalloshi-IT: Ka probleme teknike, transmetimi del pas një ore.

z. Bashkim Krasniqi: Në mbledhjen vijuese, mirë e potencoj kolegia, se ne po kemi shumë probleme me ujin, vijnë edhe mërgimtarët. Është mirë me ardhur me na sqaruar a i kanë shfrytëzuar të gjitha burimet që ka ofruar komuna, që se paku në pikun e verës të kemi ujë.

Kryesuesi i Kuvendit: Për çështjen e ujit, ne kemi pasur problem edhe në vitin e kaluar, i provuam të gjitha format me kontaktuar me Bifurkacionin, ju e dini rezultatin. Nuk patëm mundësi me u takuar, nuk erdhën me dhënë përgjegjësi, po provojmë përsëri. Pjesa, Doganaj, Elezaj -Nikaj që jemi në një rrjet të përbashkët të ujësjellësit, ata janë para një iniciative me shkëputë kontratën me kompaninë “Bifurkacioni”. Mirë që po ngritët kjo problematikë dhe me marrë masa, që kur të vjen koha e pikut, sezonit kur vijnë mërgimtarët, mos të na gjejë pa ujë. Nëse ju mendoni me futur si pikë, ndërkaq a kanë me ardhur me na u përgjigjur, nuk e di.

z. Ramadush Osmani: Të raporti i punës është subvencioni për ujësjellës, sa është investuar në vitin 2024. Me herët ua pata dërguar edhe shumën e mjeteve që është investuar në rrjetet e ujësjellësit. Përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni” nuk pranuan me qenë në interpelancë, ne kemi pasur takim me përgjegjësin -shefin ekzekutiv të kësaj kompanie dhe përgjegjësin e Kaçanikut, të njëjtën kohë kemi pasur edhe përfaqësues nga IKSHP. Nga analizat që iu kanë bërë pusit të gëlqerorja, 71 analiza, vetëm një analizë ka dalë e rritur- prezenca e manganit në ujë, të cilën instituti ka thënë të trajtohet. Ai aset është gatshëm, nëse futet në funksion, qyteti nuk do të ketë probleme as në kohën e pikut, afër 10 litra në sekondë nga pusi i gëlqeres. Mirëpo duhet të vendosen filtra për trajtimin e manganit. Kryeshefi ekzekutiv ka premtuar që kjo është çështje e kompanisë “Bifurkacioni”, mos u merrni më si komunë, se këtë punë kemi me kryer. Unë në fillim të vitit 2025 përsëri kam kërkuar me email këtyre akterëve, ta trajtoni prezencën e manganit, pasi kam ankesa nga qytetarët për mungesën e ujit. Nuk kam ende përgjigje. Investimet ku i kemi bërë janë në raport. Për pjesën e Dubravës nga jam edhe unë në atë sistem, një licencë “Bifurkacioni” e ka nga ARU, që e plotëson dhe është autoritet që jep licencë për mirëmbajtje të ujësjellësit. Nëse këta qytetarë të lokalitetit afër 9 mijë banorë, 1840 familje që janë në sistem, e ndërpresin marrëveshjen me kompaninë “Bifurkacioni”, do të paralizohet dhe i merret licenca. Ju themi me përgjegjësi të plotë, Ujësjellësi në komunën e Kaçanikut është si pasojë e mos menaxhimit të mirë. Në një takim që patëm me shefin e njësisë në Kaçanik, kemi pasur ujë për shkak të aset të pompës në Koxhaj, ku mbushën rezervuarët në Elezaj, Doganaj, me ia mundësuar Dubravës me reduktuar ujin për atë rezervuar, thonë na është djegë pompa e bunarit, kostoja 1200-1300 euro, kur të blejmë do të aktivizojmë. Mungesa e atij resursi 1 muaj ditë, ndikon të lagjia vishaj, se komuna ka menduar edhe për sistemet alternative me rënie të lirë nga bjeshkët e Sharrit, por me aktivizuar pompën në një zonë të caktuar, prurjet për fshatrat e caktuara e reduktojnë dhe e nivelojnë, por çështja është e menaxhimit të kompanisë. Nuk kemi anëtarë bordi, nuk kemi aksione si komunë, aksionar është qeveria, bordin e ka zgjedhë qeveria, kryeshefi është zgjedhë me konkurs, ne po i vuajmë pasojat menaxherie të kësaj kompanie, inkasimi është në nivel, por si sistem duhet me u mbikëqyrë 24 orë.

z. Naim Beça: E kam kërkuar fjalën para disa të tjerëve, po nejse. Se pari, gjuha vulgare e debatit që po përdorët nganjëherë, nuk po me pëlqen. Drejtor, po thoni si rezultat i keq

menaxhimit nuk kemi ujë. Unë shtëpinë e kam nga këtu shumë afër, ndërkaq që 25 vjet nuk kam ujë të mjaftueshëm verës. A do të kemi ujë është pyetja? Unë kam kërkuar në vitin e kaluar me ardhur këtu përgjegjësit e ujit me na dhënë sqarime për problemet që i ka “Bifurkacioni” apo kush i ka në çështjen e menaxhimit të ujit, se qytetarët po mbeshin pa ujë. A nuk bënë me provuar ndonjë metodë tjetër, se nëse ata nuk vijnë me sqaruar, se donë me iu ikur kamerave. Me përdorë një formë tjetër, për me pasur furnizim me ujë, me insistuar sa me parë me pas pompën për filtrimin e ujit nga prezenca e manganit.

z. Agim Mani: Mendoj se ia vlen me u diskutua çështja e ujit, por çështja është se kompania dhe drejtorja ia hedhin fajin njëri tjetrit. Kompania merret me menaxhimin e ujit, ndërkaq drejtorja merret me prurjen e ujit. A e keni pru ju ujin e mjaftueshëm, që me u furnizuar mjaftueshëm komuna e Kaçanikut. Në Ivajë është rezervuari 1 milion litra, por është thatë, sepse nuk e keni pru ujin. Informatat i kam shumë të sakta. Ju e dini që kanë provuar me aktivizuar atë rezervuar, kanë plasë gypat, se nuk i përballon.

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna ka investuar në rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimit, sa për informacion. Por të jeni të bindur në gjitha takimet me OJQ qeveritare dhe joqeveritare, na kanë thënë se komuna nuk ka të drejtë me investuar në këto rrjete, bile na kanë thënë se është e kundërligjshme komuna me investuar, duhet me investuar ai që e menaxhon dhe mirëmban. Unë po pajtohem me juve, por po kërkoj që, drejtorin e kompanisë që po e kërkojmë dhe drejtori këtu, me ardhur me sqaruar se këtë çështje sesi me zgjidhur. Nuk po e trajtojmë këtë çështje politikisht, por si një nevojë elementare.

znj. Ardita Rrahmani: Katër muaj ditë unë e kam ngritur këtë çështje këtu në KK. Me vjen mirë që për herë të parë Naimi na ftojë me shkuar në zyre të kompanisë, se kur kam thënë unë, asnjëri nuk me është përgjigjur. Po me vjen mirë që Naimi po i prinë kësaj pune, ndërkaq nga 1 anëtar nga secili subjekt politik t’i bashkohet, me shkuar e me zgjidhur problemin. Me vjen mirë që me gjasë, me në fund e paskemi njëfarë imuniteti me shkuar me zgjidhur problemin e ujit, e jo vetëm me fol. Problemi i mungesës së ujit nisë në Kaçanik nga muaji maj, lë të na prinë Naimi, në pauzë nisemi, nëse nuk na hapin derën, ulemi para dyerve të kompanisë, por jo me gjuajtur me diçka.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk është askush kundër për mos me pri e mos me shkuar, por çështja është: A ka nivel përgjegjësie dhe llogaridhënie? Ne mundem me shkuar dhe me u kthyer, mundemi me i thirrur disa herë e mos me ardhur.

znj. Ardita Rrahmani: E shterim fillimisht këtë mundësi, pastaj i thirrem edhe ndonjë TV.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë e tregova masën, e heqim orën dhe nuk paguajmë më kompanisë.

z. Selajdin Troni: Me vjen mirë që është ngritur kjo çështje, pajtohem me mendimin e Naimit dhe Arditës, sa nuk është bërë vonë, me formua një grup punues dhe me shkuar të “Bifurkacioni”. Cilido nga ne mundemi me ardhur, duhet të provojmë, e jo me bërë politikë verës se kush e ka fajin. Unë nuk e mbroj askënd, kushdo që e ka gabimin, lë ta merr përgjegjësinë.

znj. Kadrije Lika-Troni: E kam një pyetje për drejtorin e arsimit: Të sigurimi i transportit të nxënësve të shkollës IIAP” Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” dhe shkollat tjera, është cekur se në vitin 2023-2024 sikurse në vitet e kaluara DA është duke i subvencionuar 100% shpenzimet e transportit. Në mbledhjen e fundit të KPF bëra pyetje se, a po mbulohen me transport 100% të gjithë nxënësit. Përgjigja ishte nga klasa 1-5 mbulohen 100%, ndërsa nga klasa 6-9, shuma 50%. Në raportin e ekzekutivit nuk po shoh se mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit për nxënësit e klasave 6-9 është 50%. Në Raport është cekur se mbulohen shpenzimet e transportit 100%.

Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut, nëse iu paguhen 100% disa nxënësve, ndërsa për disa paguajnë prindërit 50%.

z. Zahir Doda: Është çështje e detajeve, se me i shkruar detajet, raporti del shumë i gjerë. Nuk është puna që kam dashur me i ikur diçka, se ka edhe raste tjera, ku iu paguhen nxënësve 50% e shumë, këto janë detaje.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse cekët, shuma 100% mbulohet transporti i nxënësve për disa shkolla, normal se duhet cekur se disave iu mbulohet transporti 50%. Ajo është e arsyeshme dhe e kuptueshme. Ndërkaq nëse thuhet vetëm si fjalë, sa me u arsyetuar ne para qytetarëve, nxënësve, prindërve, ajo është çështje tjetër. Nëse ka qenë ndonjë lëshim teknik i juaji, ajo arsyetohet. Këtë që po e thoni ju, unë nuk pajtohem absolutisht. Duhet me ditur a iu paguhet 100% transporti i nxënësve nga klasa 6-9, shkaku i largësisë për me vijuar mësimin në shkolla. A qëndron ajo që e keni thënë në KPF, apo kjo që e keni shkruar në raportin e ekzekutivit, se po del në jo proporcion të asaj që është thënë me këtë që është shkruar.

z. Zahir Doda: Ajo që e kam thënë, qëndron.

z. Bashkim Luma: Çështja e transportit të nxënësve, a i merrni informatat nga shkollat për lartësinë e shkollës, apo nxënësit duhet me bërë kërkesë në drejtori për me i futur në pagesën e transportit.

z. Zahir Doda: Ne marrim informacione, por edhe prindërit lajmërohen vet. Pagesa iu bëhet nxënësve në vijë ajrore mbi 4 km. Asnjë nxënës në Gllaboçicë, nuk e ka largësinë e shkollës mbi 3.5 km. Me hapur këtë temë, dalin shumë që nuk i plotësojnë kushtet, se janë shpërngulur banorët. Të dhënat i kam të gjitha.

z. Bashkim Luma: Distanca në vijë ajrore, nuk pajtohem, se ata udhëtojnë në vijë rrugore me kombi, e jo me aeroplan. Duhet të matet distanca rrugore e jo distanca ajrore, distanca rrugore del me tepër se 3.5.

z. Zahir Doda: Në vijë ajrore paguhet rruga, në distancë mbi 4 km. Në momentin që vendoset ndryshe, keqpërdoret.

z. Bashkim Luma: Unë po flas për një rast konkret, ata nxënës nuk ka rrugë tjetër të transportit, është e vetmja rrugë që kanë, 3.5 km.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është çështje ligjore. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 104/02-4044/25.

Pas kësaj pike, u realizua një pauzë, 30 minuta, ndërkaq nga ora 14:00, Kuvendi vazhdoi me punimet e mbledhjes. Pjesëmarrës 24 (12 të PDK, 2 të AAK, 7 të LVV, 3 të LDK). Nuk janë prezentë në pjesën e dytë të mbledhjes: Agim Çaka, Raif Kasa, Betim Shala.

4. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Një raport i brendshëm bëhet për Zyrën e Kryetarit, për me njoftuar kryetarin për të gjeturat. Me herët është bërë vetëm për kryetarin, mirëpo tani po kërkohet me u shqyrtuar në KK, për shkak të GP, se KK e diskuton Raportin e Auditimit të Zyrës kombëtare. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Auditori i brendshëm siç e potencuat edhe ju kryesues, e ka një rol këshillëdhënës ndaj ekzekutivit, por nxjerrë edhe rekomandime. Nga 42 rekomandime të

nxjerrë, 15 janë zbatuar plotësisht, 14 pjesërisht, tjerat në fazën e zbatimit, d.m.th. zbatimi i rekomandimeve është e vogël. Mendoj se duhet të bëhet një Plan për zbatimin e rekomandimeve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024/Lënda: 01Nr. 470/03-3108/25.

5. Informatë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Informata hartohet nga Zyra e personelit. E hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: Anulimet e shpeshta të konkurseve në komunën e Kaçanikut, është bërë një dukuri shqetësuese. Po ngiti pyetjen, pse jo transparencë dhe seriozitetin e procesit të rekrutimit? Nuk është normale që konkurset të shpallen disa herë, duke krijuar paqartësi, vonesa dhe mundësi të manipulimeve. Ky lloj menaxhimi, jo vetëm që cenon besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike, por dëmton integritetin e procesit të punësimit dhe i lënë kandidatët që kanë aplikuar në pasiguri. Për këtë dukuri të pashpjeguar, kërkoj të bëhet një proces i drejtë dhe transparentë, që respekton ligjin. Nëse din dikush të më shpjegon, pse po anulohen konkurset me tepër se 2 herë?

Kryetari i Komunës: Meqë zyrtaren e kemi në një trajnim dje dhe sot, po mundohem në pika të shkurta me dhënë sqarime. Zyrtarja me ka thënë: Nëse kanë diçka konkrete, iu përgjigjem me shkrim. Sa i përket manipulimeve që u përmend, janë organe tjera që merren nëse ka, dhe i sugjeroj secilit që ka informacione, me iu drejtuar atyre organeve, për atë e përgëzoj secilin që ka informacione të tilla e ju drejtohet organeve përkatëse. Sa i përket çështjeve tjera, po filloj prej arsimit. Kanë ardhur do rregullore të reja, që është problem me përcaktuar një kandidat sesi me kaluar. Përpara kur e ka kaluar kandidati testin me 51 pikë, kemi thënë veç kush është në rend, se për ndryshe kalon, ndërkaq tani, me rregulloren e re ka ndryshuar formati, nga 51 pikë, kthehesh në 25, e duhesh me i kaluar 75 pikë me kaluar testin. Kjo ka qenë arsyeja që nuk kanë mundur me kaluar. Ka qenë një pyetje, kryetar bëni pyetjet me të lehta? Ne kemi dashur me ngritur një cilësi, kjo ka qenë arsyeja, e kemi ngritur këtë çështje përmes DA se çka mundemi me bërë tani e tutje. E dyta: Kemi konkurse kur nuk vijnë kandidatët adekuat dhe duhet patjetër me anuluar konkursin. Për pjesën tjetër, që mendoni se ka parregullsi, jam me juve që me përcjellë aty ku duhet çështjen dhe unë ju kisha mbështetë.

znj. Ernesta Krasniqi: Për mua ka qenë i pakuptimtë një konkurs i hapur: Zyrtar për çështje pronësore. Është hapur konkursi me 27.11.2024, është anuluar me 29.11.2024 dhe po atë ditë është hapur përsëri. Brenda 5 ditëve ky konkurs është hapur, është mbyllur dhe është hapur përsëri. Tjetra: Në shkollën "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër, është anuluar konkursi 2 herë për mësimdhënësit të Fizikës. Mësimdhënësjat aktuale ka qenë në pushim të lehonisë. Ne e dimë që marrin pushimin e lehonisë me herët, bëjnë kërkesën të paktën me herët, që me i marrë veprimet e nevojshme me herët për plotësimin e vendit të lirë, që nxënësit mos me mbetur pa mësim- mësim të lëndës së Fizikës, se nxënësit po bëjnë shumë mungesa. Kanë kaluar gati 3 muaj që nuk është përfunduar konkursi dhe me u gjetur mësimdhënësi i lëndës së Fizikës. Njëjtë ka ndodhë edhe për lëndën e Historisë, në shkollën e Stagovës. Këto po shkaktojnë probleme në shkolla, se nxënësit po duhet me i bartë nëpër klasa, ose me zëvendësuar ndonjë arsimtar. Për këtë arsye, mendoj se duhet me qenë me korrekt dhe me i respektuar ligjet.

Kryetari i Komunës: Ernesta, nuk i di detajet pse është anuluar konkursi dhe është hapur përsëri, por të pjesa e fizikës dhe historisë, e kemi drejtorin këtu. Lënda e Fizikës e kemi të

pambuluar edhe sot, se nuk ka kuadër adekuat. Janë shumë gjëra që po kemi konkurse. Të lënda e Historisë, jemi duke pritur vendimin e gjykatës. Për lëndën e Historisë është anuluar konkursi për shkak të një kontesti që e ka apeluar dikush në gjykatë. Besoj se gjykata do të jep një vendim se ku është defekti. Të lënda e Fizikës, edhe sot e kemi problemin, se nuk kemi profesionist dhe sot askush nuk e merr përgjegjësi për atë lëndë pa qenë profesionist, përkundër asaj që nxënësi mbetet pa mësim. Tjetra: Kushtet e konkursit janë të përcaktuara se kur hapen. Është drejtori i DA që ka një përvojë të gjatë në këtë drejtim, i cili është shumë preciz dhe nuk e kontestoj absolut procedurën e përzgjedhjes. Për atë e theksova në fillim, nëse ju keni elemente të dyshimit për manipulim, do të iu kisha sugjeruar me lajmëruar në organet përkatëse.

znj. Ernesta Krasniqi: Që një konkurs brenda 5 ditëve hapet, mbyllet dhe rihapet po atë ditë, të krijon hapësirë për me menduar se ka manipulime dhe jemi të paqartë pse po ndodhin këto. Ndoshta nuk mundesh me dhënë përgjigje adekuate, kërkoj përgjigje me shkrim, se unë i përcjellë krejt konkurset, sidomos konkurset e vitit 2024. Ka pasur shumë konkurse që janë anuluar dy apo tre herë dhe janë rishpallur përsëri. Nuk besoj që nuk ka njerëz adekuat, të paktën në rihapjen e dytë të konkursit. Nëse në konkursin që rihapet pranohet i njëjti kandidat që ka aplikuar kur është shpallë për herë të parë konkursi, nuk është që nuk ka njerëz adekuat, se ka njerëz që aplikojnë dhe ndodhin anulimet e konkurseve. Ka edhe konkurse që ndoshta anulohen se nuk ka kandidat adekuat për lëmi të caktuar, por ka edhe arsye tjera të anulimit të konkursit.

Kryetari i Komunës: Nëse ka pasur kandidat, e nuk ka mundur me kaluar testin, normal se konkursi përsëritet dhe kandidati nëse nuk e ka dhënë testin herën e parë, herën e dytë ka mundësi që e ka dhënë, për atë është i njëjti person që u pranua. Herën e parë ka pasur mundësi që ka qenë i papërgatitur, herën e dytë është me i përgatitur. Testi për shërbyes civil, jepet në Prishtinë.

znj. Ernesta Krasniqi: Pyetje; A ka konkurse që janë hapur, janë anuluar dhe nuk janë hapur për një vit apo për shumë vite. Kërkoj të me jepet një përgjigje me shkrim, nëse ka pasur ndonjë konkurs. Përgjigjen nuk po e kërkoj nga ju kryetar. Në momentin kur hapet një konkurs për një pozitë, ne e dimë se institucioni ka nevojë për atë pozitë.

Kryetari i Komunës: Mos të hymë ne detaje, se mundem me gabuar. Ia adresoni një kërkesë zyrtarisht, Zyrës së Personelit, dhe jam shumë i bindur se do të përgjigjet.

znj. Ernesta Krasniqi: Unë po e bëjë kërkesën këtu, besoj se ajo (fjala është për udhëheqësin e Zyrës së personelit) e përcjellë seancën.

Kryetari i Komunës: Unë gjerat në vija të trasha i di, por jo në detaje, kështu që po të inkurajoj që lirisht ia adresoni një kërkesë, në emailin zyrtar, edhe kërkesën e parë që e potencove, për dyshime në manipulime, besoj se ju përgjigjet Zyra e personelit.

z. Rustem Zenuni: Unë e kam pasur një çështje me adresuar të pyetjet dhe kërkesat, po e ngriti të kjo pikë. Ernesta është duke punuar në komunë. A është konflikt i interesit Ernesta me qenë edhe anëtare e KK edhe punëtore në komunë?

znj. Ernesta Krasniqi: A duhet me ta dhënë përgjigjur këtu, apo me bënë me shkrim?

Kryetari i Komunës: E njëjta kërkesë vlen edhe për Rustemin.

Kryesuesi i Kuvendit: Rustem, mundesh me ju drejtuar Zyrës ligjore për këtë çështje, se Ernesta faktikisht nuk është punëtore e komunës. Sa i përket çështjeve të konkurseve, pa përjashtua se mund të ketë ndonjë parregullsi, por me tepër që i përcjellin kandidatët- ata që i

prekë direkt kur ka ndonjë parregullsi, nuk mundet me i përcjell as ne, kështu që rrini rehat për këtë çështje. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me aktivitetin e Zyrës së Personelit, përmes materialit, Informatën për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për vitin 2024/Lënda: 01Nr. 104/02-3810/25.

6.Informatë për Përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2024/2025;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Arta Avdiu: Në këtë informatë kam vërejtur disa parregullsi, si rënia e numrit të nxënësve. Ky është një shqetësim i madh, sepse nëse vazhdohet kështu, rrezikohet mbyllja e shumë shkollave në një të ardhme të afërt. Shqetësim tjetër është mungesat e nxënësve dhe arsimtarëve. Vetëm në gjimnazin Skënderbeu dhe SHMP janë diku 26495 mungesa, nëse pjesëtohet me numrin e nxënësve, i bien diku 26 mungesa për kokë nxënësi. Desha me pyetur drejtorin, çfarë masash keni me marrë për me ndryshuar këtë gjendje?

z. Agim Mani: Pajtohem me mendimin e Artës, se me të vërtetë është shqetësuese rënia e numrit të nxënësve. Nëse bazohemi nga vitet 2017, 2018, numri i nxënësve është me i vogël, për mbi 1500 nxënës. Gjithmonë e kam përgëzuar drejtorin për raport të sakët, ndërkaq nuk pajtohem me drejtorin sa i përket formës së tabelës, tabela me nr. 5. mungesa e numrit të arsimtarëve në shkollën “Agim Bajrami”, ka pasur me së shumti mungesa, se komplet gjysmë vjetori i parë ka qenë pa një arsimtar. Humbja e orëve është 236. Nëse një arsimtarë ka humbur një orë, atëherë nxënësit kanë humbur 20 orë, dhe kjo nuk është e drejtë. Këto duhet me i paraqit drejtor, kjo është shqetësuese, se këto orë duhet me i zëvendësuar. Nëse arsimtari i ka humbur 20 orë, atëherë shtrohet pyetje, sa orë i kanë humbur nxënësit me humbjen e asaj ore. Është dashur me i paraqitur në formë tabele edhe orët e humbura të nxënësve, që ka ndodhë si rezultat i humbjes së orës së arsimtarit.

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj përgjigje të furnizimi i nxënësve me libra, pasur parasysh problemet që janë ballafaquar në këto vitet e fundit. Në informatë thuhet, pas verifikimit të listave, janë 312 emra të nxënësve që janë subvencionuar, por që nuk janë në komunën tonë. Kjo lënë hapësirë qartazi për manipulime. Çka po ndodhë, kush po e bënë këtë dhe a është kërkuar përgjegjësi prej ministrisë? Nëse e kalkulojmë numrin e nxënësve me 80 euro, i bien një shumë bukur e madhe, se nuk është në rregull, në anën tjetër e keni përmendur se ka familje që për shkak të mos qasjes në e-Kosova kanë mbetur pa subvencionuar me mjete prej 80 euro për libra.

z. Zahir Doda: Faleminderit për vlerësimin e informatës, mundet me pasur edhe defekte, megjithatë jemi munduar me qenë korrekt. Zvogëlimi i numrit të nxënësve, është shqetësuese, ka rënie shumë të shpejtë të nxënësve, e cila rënie ndikon edhe në zvogëlimin e numrit të punëtorëve, që mundet brenda vitit me u zvogëluar prej 15-20 arsimtarë, e që deri tani nuk kam asnjë jashtë listës së pagave. Përgjigje për pyetjen e Ernestës: Konkursi për specialist të IT, është shpallë në kohën kur kam pasur hapësirë, nuk ka fituar askush se nuk ka pasur kandidat adekuat, nuk ka ardhur askush se paga ka qenë e fikse. Tani nuk e kam asnjë vend të lirë, ndërsa nevojë ka. Tani nuk e kam asnjë vend të lirë, edhe nëse shkon në pushim të lindjes ndonjë arsimtare. Në momentin që krijohet mundësia, e shpalli konkursin për IT. Për këtë vend është shpallë konkursi, dhe më nuk është ri shpallë. Të konkurset tjera, janë pjesë e personelit, kështu që nuk e di rregulloren mirë dhe nuk dua të hy në atë çështje. Të numri i mungesave, ka mungesa të nxënësve dhe arsimtarëve, nuk po mundem me gjetur strategji si me ndalur. Kemi tentuar në forma të ndryshme, është rregullorja, e kemi aplikuar, kemi bërë transfere çka kemi pasur mundësi. Çdo masë është me vendime. E kam plotësuar numrin e psikologëve, pedagogëve, në shkolla, aq sa kam pasur mundësi, është edhe një logoped, se ishte nevojë e kohës. Ata mundohen me punuar me fëmijë, por e vërteta është se është numri i madh i

nxënësve. Të pyetja e Agimit, nuk mundemi në mungesë të arsimtarit, me ua proceduar nxënësve orët e humbura. Numri i orëve nuk lidhet me numrin e mungesave të nxënësve. Edhe me dashtë nuk di ku me ua proceduar, me propozoni ju një tabelë, unë e plotësoj.

z. Agim Mani: Çdo orë e humbur duhet me u zëvendësuar. Ka pasur raste kur janë zëvendësuar ditëve të shtune.

z. Zahir Doda: Nëse e shumëzojmë numrin e orëve të humbura në shkollën e Stagovës, me numrin e nxënësve, del 5000 orë të humbura. Nuk janë humbur 5000 orë. Tregoma ti me shkrim qysh me plotësuar tabelën, unë e plotësoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Mungesat e nxënësve dhe mungesat e arsimtarëve janë dy kategori të ndryshme. Janë të shënuara të orët e pa mbajtura.

z. Bashkim Luma: A keni marrë masa, se janë 236 orë të humbura në shkollën “Agim Bajrami” në Stagovë? Me krahasuar me shkollat tjera, mesatarja është shumë e lartë e orëve të humbura?

z. Zahir Doda: Është e vërtetë, ka munguar arsimtari. Janë disa faktorë, për me zgjedhur një arsimtar, me ligj ka qenë si çdo zyrtarë publik, procedura zgjatë 2 muaj e gjysmë. Tani është bërë diçka, se janë specifika tjera në arsim, kam mundësi me bërë diçka në këtë drejtim. Kjo ka qenë çështja dhe Zyra e personelit tani me ka anuluar një konkurs. Mungesa e mësimdhënësve, është e vërtetë se ka defekte, por kjo ka qenë shqetësim edhe i imi. Të çështja e librave, e kam paraqitur si shqetësim, nuk është obligimi ynë se aplikimin e bëjnë drejtpërdrejtë prindërit për libra. Ministria i lëshon mjetet për krejt ata emra, pasi ti kryen, na dërgon një listë në komuna me i verifikuar dhe ata marrin masa, ne vetëm ju tregojmë. Në Kaçanik janë lëshuar 312 komplete të librave për fëmijët që nuk janë këtu, se ka aplikuar ndoshta prej Gjermanie dhe iu kanë shkuar mjetet. Këtë shqetësim e kemi ngritur si komunë para se me ndodhë që dy herë. Për hera e parë përpos Kamenicës, jemi kanë për me ndërruar metodën që librat t’iu shkojnë fëmijëve, nuk kanë dëgjuar. Është e vërtetë se janë në listë 312 komplete që iu kanë dalë mjetet, e që nuk janë këtu, këtë e kemi përcjellë në ministri, a marrin masa a jo nuk e di.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Kush e heq mëditjen kur mungon profesori, arsimtari dhe a iu hiqet mëditja, se kur të hiqet mëditja, nuk besoj se mungojnë shumë? Unë kam biseduar me zëvendës drejtorin e shkollës “Emin Duraku”, me ka thënë se nuk kam kompetencë me hequr mëditjen për mungesa të arsimtarëve.

znj. Florina Lika-Vishi: Kam respekt për drejtorin e arsimit. Kam një kërkesë për një psikolog dhe një logoped në SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, pasi kjo shkollë ka numrin me të madh të nxënësve, është e ndarë në 3 paralele, kështu që cikli i ulët të ketë psikologun dhe logopedin e vet, ndërsa cikli i lartë të ketë psikologun dhe logopedin e vet, për me i parandaluar problemet sociale dhe disiplinore, për me i mbështetur prindërit dhe arsimtarët për qasje të duhur për menaxhimin e situatave sfiduese, se ka shumë nevojë.

z. Naim Beça: E potencove drejtor se e keni një rregullore për mungesat e nxënësve, i merrni veprimet e nevojshme sipas saj, si para përjashtim, përjashtim nga shkolla, për arsimtarët që mungojnë. A keni larguar ndonjë arsimtar nga shkolla me transferuar diku tjetër, për shkak të mungesave? Si i cilësoni arsyet e mungesave, janë pushimet mjekësore etj. A bëhen raporte për mungesa të arsimtarëve, si arsyetojnë ata arsimtarë mungesat kur mungojnë, sepse me marrë pagë pa ardhur në punë me parat e taksapaguesve, kjo nuk është në rregull.

z. Selajdin Troni: Qysh munden me aplikuar dikush për mjete për libra, pa qenë nxënës i shkollave të komunës? A kërkohet të dhëna nga komuna me ditur sa nxënës i ka komuna?

Kryesuesi i Kuvendit: Sistemi ia ka lejuar. Përpara librat e nxënësve kanë ardhur në shkollë, ndërkaq tani aplikimi bëhet nga shtëpia dhe i procedohen mjetet në konto.

z. Zahir Doda: Për heqje të mëditjes, mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i shkollës është drejtori. Ai drejtor që të ka thënë, i thoni dërgoja raportin e mungesave drejtorisë së arsimit. Një pjesë e madhe e arsimtarëve vijnë me vërtetime mjekësore. Unë për ata arsimtarë nuk mundem me marrë asnjë veprime. E kam pasur një rast ka shkuar në Turqi pa fije pune, e kam dërguar në komision disiplinor, e ka sjellë një vërtetim mjekësor dhe komisioni me ka kthyer në punë.

z. Naim Beça: Edhe pushimet ndahen me kategori, pushim ditor, vjetor etj. Me pas qenë drejtori këtu na i kishte sqarua.

z. Zahir Doda: Në arsim janë disa specifika të veçanta, ka raste kur edhe unë i jap pushim me pagesë, se ka që janë me sëmundje kaceri, ata nuk mundem me ardhur fare në punë. Me shikuar me ligj, pas 3 muajve duhet me hequr nga lista e pagave, por kush mundet me marrë një veprim të tillë për një arsimtar që ka punuar 30 vjet në arsim.

z. Naim Beça: Edhe pushimi mjekësor është me shkallë, dikush veç për dhimbje koke me marrë pushim vjetor, e mos me ardhur dy javë në punë, kjo nuk është në rregull. Edhe sigurimi shëndetësor privat etj. që bëhet i ka të kategorizuar pushimet mjekësore, pushimi kronik për 1 ditë, ose e hapë pushimin vjetor, për të cilin duhet me njoftuar drejtorin e shkollës.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundet me marrë veprim drejtori, kur e ka një pushim vjetor prej 7 ditësh fjala vjen, që ia lëshon mjeku për regjim shtrati.

z. Zahir Doda: Shkollat kanë nevojë edhe për staf tjetër, si psikolog e logoped, dhe për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, por tavani është i kufizuar dhe nuk mundem, në këtë muaj është e mbushur, pos një vend i lirë është në shkollën e mesme.

z. Bashkim Luma: Të suksesi i nxënësve sipas shkollave, tabela nr. 4, çuditërisht 2 shkolla në nivel të komunës janë me sukses negativ 0%. Është një arritje shumë e mirë, ose është mirë të vërtetohet, sepse nuk kam dëgjuar ndonjë rast kështu, me qenë suksesi negativ në ndonjë shkollë në nivel të shkollave.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse është suksesi negativ në nivel të shkollave, nuk bënë hiq. Niveli me qenë negativ në krejt shkollat, duhet me dalë 1, me dalë negativ, e 1 nuk besoj se ka asnjë shkollë.

znj. Ardita Rrahmani; Në KPF e kemi diskutua se është shqetësuese nota mesatare 2.8 në SHMP dhe 3.4 në gjimnaz. Kjo është shqetësuese, për me ngrit cilësinë në arsim, për me rikthyer emrin e SHMP dhe të gjimnazit siç ka qenë me herët.

z. Zahir Doda: Qëllimin e kemi edhe ne edhe ju për me mirë, po mundohem aq sa mundem, kjo është relative, ka mundësi me mirë. Raportet i kemi marrë prej drejtorëve, tani nuk po mundem me u përgjigjur. Keni të drejtë, kjo nuk është në rregull, por kështu janë shifrat. Mundem me u marrë me këtë punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatohet se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me aktivitetin e drejtorisë së Arsimit, përmes Informatës për Përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të vitit shkollor 2024/2025/ Lënda: 01Nr.04-610/01-3882/25.

7. Plani vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për periudhën Janar-Dhjetor 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë dokument e kemi trajtuar edhe në KPF, ishte një shqetësim i Agimit, se mbledhja e muajit shkurt, të bartët në muajin mars. Kjo ka ndodhë se ne e kemi trajtuar në janar raportin e punës, para se të trajtonim planin e punës. E hapi diskutimin;

z. Agim Mani: Ashtu si e potencove kryesues, e kemi trajtuar këtë çështje edhe në KPF se është e pamundur me u mbajtur një mbledhje e KKSB në muajin shkurt, pa u votuar plani, kështu nëse ç vendoset për muajin mars ajo mbledhje, ne jemi për.

Kryesuesi i Kuvendit: Me ndryshimin që u propozua, e shtroj në votim për aprovim planin e KKSB, dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 24. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për periudhën Janar-Dhjetor 2025/ Lënda: 01Nr. 104/02-3729/25.

8. Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;

Kryesuesi i Kuvendit: Materiali është bukur i gjerë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Në KPF e kemi diskutuar këtë çështje, duke iu falënderuar drejtorit që paraprakisht i ka paraprirë diskutimit. Shpresoj që ky dokument që na ka ardhur, që nuk është për herë të parë, të paktën me filluar me gjetur zbatim deri në vitin 2035, të paktën 35% sipas juve qysh e potencuat drejtor me qenë mbulueshmëria në këtë plan. Po e ri përsëris pyetjen për të tjerët jo për juve, në lidhje me deponinë që është kërkuar në Runjevë nga një person individual, me lëshuar tokën për deponi: Çka kanë të përbashkët, a kanë diçka të përbashkët dhe sa e lehtëson, sa ndikon kjo në zbatimin e këtij plani?

z. Ramadush Osmani: Është një plan bukur voluminoz dhe ambicioz, për arsye se ngërthen në vete një strategji të re për menaxhimin e mbeturinave, për me kaluar nga sistemi aktual sistemin linear, ku 100% e mbeturinave deponohen dhe dërgohen në deponinë e Velekincës si deponi rajonale. Ky plan është produkt i një vendimi të mëhershëm që është marrë në KK për nismën e bashkëpunimit ndër komunal për fushën e menaxhimit të mbeturinave. Pas planit do të vjen marrëveshja e bashkëpunimit ndër komunal, ku caktohen përgjegjësitë e secilës komunë për zbatimin e tij. Synohet të fillohet me sistemi e integruar të menaxhimit të mbeturinave, nga baza ku do të fillohet me ndarjen e mbeturinës në bazë, riciklim, ripërdorim dhe reduktim të mbeturinave, me 3 kanta, për me vazhduar me sistemin tjetër ku do të dërgohet me ndarjen e komplet mbeturinave, para se të groposen. Synohet deri në vitin 2033, më mbetur diku 25% e mbeturinave pa groposur, të cilat e kanë procesin e ripërdorimit të tyre. Vendimi për caktimin e lokacionit për mbeturina inerte, është në frymën e këtij plani, për arsye se komunat e kanë obligim caktimin e lokacionit për deponi inerte të mbeturinave. Këto mbeturina nuk hynë në grupin e mbeturinave të rrezikshme apo që dëmtojnë ambientin, por në mbeturina të vrazhda, ne jemi në hapin që e kemi caktuar lokacionin për trajtimin e këtyre mbeturinave. Lokacioni ka me iu nënshtruar para hapjes vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pajisjet për bluarjen e kësaj mbeturine, e cila kthehet në përdorim. Aktualisht është 0%, ripërdorimit inerte, në vitet vijuese synohet në diku 30-40% të kthehet në ripërdorim. Është bërë vlerësimi strategjik i planit, ku është trajtua bukur mirë secila komponentë e ardhme e mbeturinave, jemi gati të fundit si Kosovë që po i marrim praktikat e shteteve tjera për trajtimin e kësaj mbeturine.

Kryesuesi i Kuvendi: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 24. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt/Lënda: 01Nr. 104/02-3943/25.

z. Naim Beça: A mundem me dërguar në deponi, mbeturina inerte?

z. Ramadush Osmani: Sa të hartojmë planin e veprimit të ndikimit në mjedis të lokacionit, ta integrojmë në PZHK, lokacioni është i gatshëm për përdorim. Do të kemi edhe Rregulloren e taksave, ku parashihet edhe taksa për deponim të asaj mbeturine.

9. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Elezaj dhe ZK Bob;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori nuk është këtu, i ka caktuar zyrtarët nga drejtoria e tij. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Të parcela kadastrale 00733-11 për ZK në Bob, nuk e kemi fletën poseduese dhe kopjen e planit, në bazë të cilave do të shihej saktë destinimi dhe lloji i pronës. Mungesa e këtyre dokumenteve, situacioni bardhë e zi, është përsëri një tendencë për ti lënë të painformuar qytetarët. Parcela kadastrale 00733-11 e Rufki Zharkut, është e pafavorshme, sepse është një rrëpirë, në tërësi i papërdorshëm dhe i panevojshëm për zgjerimin e hapësirës publike-oborrit të SHMP. Në tërësi ky është propozim për këmbim, i panevojshëm, dhe i vetmi qëllim është mbulimi i uzurpimit, sepse shihet se 2 shtëpi janë të ndërtuar në një pjesë të parcelës 00154-1 siç shihet në orto foto. Ky propozim vendim është vetëm për të vënë në lajthitje KK.T ë Parcela kadastrale në Elezaj, është i pa menduar mirë ky propozim vendim, dhe i gabuar si nga aspektin e gjeometrisë së rrugës, po ashtu dallimin mes sipërfaqes që merr dhe jep komuna. Nga skica e gjeodetit të licencuar, Liridon Salijaj, shihet se pronarët privat japin 207m², ndërsa komunës i mirën 274m². Pyetje për kryetarin dhe drejtorin, ku është interesi i komunës në këtë rast, a e kishit dhënë me këto kushte pronën e juaj? Në aspektin e gjeometrisë apo trajektores së rrugës, kjo nuk rregullon asgjë, kjo është kërkesë private në të cilën përfiton personi private, dhe ky propozim pa u bazua në ndonjë projekt të rrugës në përgjithësi, propozohet kuturu. Ky këmbim, krijon një precedentë në damë të komunës. Drejtori në dy raste të pikës 9, është duke dëmtuar pronën komunale dhe duke vënë në lajthitje KK, me propozime që nuk kanë bazë me plan urban apo projekt të asaj rruge. Drejtori nuk është këtu, kryetari ose zyrtarët lë të na japin sqarime pse lënda nuk ka kopje plani as fletë poseduese të PK në ZK Bob.

z. Visar Mulaku-zyrtar në DUKMM: Për çështjen pse nuk janë në lëndë kopja e planit dhe fleta poseduese për PK në ZK Bob, ne i kemi përcjellë, nuk e di pse nuk janë dërguar. Arsyeja pse po shpallet me interes kjo pronë, për zgjerimin e rrugës së SHMP, e kemi një kërkesë nga një qytetar i Kaçanikut, i cili e ka interesin aty. Interesi nuk e di se cili është, se nuk jam marrë me këtë lëndë. Të ZK në Elezaj, edhe për këtë e kemi një kërkesë të një qytetari, gjeodet është Liridon Salijaj. Nuk do të thotë që ka kaluar, ai shpreh interes për zgjerimin e rrugës "Qamëria". Për metrat katror që nuk janë në përputhje, bëhet vlerësimi financiar në ministri, vlerësimet ju vijnë në KK. Të pjesa të shkolla Voskopoja, në gjeoportali orto fotot janë të vitit 2018, tani ka hyrë në vitin 2024 edhe zona urbane fotografimi, që po thuhet janë 2 shtëpi, në skicë nuk paraqitet objekti, nuk do të thotë se është komplet shtëpia, mundet me qenë një cep i shtëpisë i parcelave me interes.

znj. Kadrije Lika-Troni: Paraqitja këtu me gjeoportali ndryshon, unë i kam hulumtuar dhe i kam gjetur. A nuk janë të rregulluara këto.

z. Visar Mulaku: Janë të rregulluara. Aty ku po thuhet janë 2 shtëpi, në skicë nuk paraqitet objekti, nuk do të thotë se është komplet shtëpia, mundet me qenë një cep i shtëpisë, por vetëm i parcelave me interes.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryetar, desha me pyetur: Nëse ne këtu bëjmë këmbim 207 m² i marrim, i japim 274m², a ju doket kjo në rregull? Se nuk është në rregull me bërë përmirësime pasi të kalon në KK, mua nuk me duket e arsyeshme.

Kryetari i Komunës: Edhe Propozim Vendim i drejtorit, për çështje profesionale përgjigjet drejtori. Sqarimet i dha zyrtari i kadastrit, vlerësimi i pronave bëhet në ministri. Vendimi për këmbimin e pronave vjen në KK, merret vendimi i dytë. Nëse i merret ajo pjesë, ai ka me kompensuar. Ka pasur raste kur këmbimi ka qenë në favor të komunës, i është marrë me tepër, i është dhënë me pak. Këtë herë është e kundërta, e ka pasur fatin dhe ne nuk mundem me penguar këtë çështje, sa e kuptova nga zyrtari i DUKMM.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ne fillimisht po i nisim punët me gabime, pastaj po na i kthejnë ministria, dhe gati në çdo seancë po kemi rishqyrtim të vendimeve, për gabimet që i bëjmë.

Kryetari i Komunës: Këto gjëra kanë ndodhur me herët dhe duhet me i korrigjuar. Sipas juve, a duhet me i korrigjuar gabimet që janë bërë para disa viteve, apo me i lënë ashtu? Defektet janë pa me vonë, pasi është shtruar rruga, pronari kërkon me rregullua. Mendoj që kemi zgjedhur formën me të mirë që po i zgjidhim këto probleme, ndërkaq tani e tutje, kemi qenë pak me të kujdesshëm në shumicën e rasteve. Edhe pse është pak vonë, unë jam me i korrigjuar, mos të iu lëmë telashe të tjerëve, por me pasur kujdes mos me ndodhë raste tjera. Këto rrugë janë bërë shumë herët, janë shtruar me vonë në ata kufijtë.

Kryesuesi i Kuvendit: E rëndësishme është se qëllimi është i mirë, që po korrigjohen gabimet në këtë rast, se ka që dikush ka dal në pronë të komunës, aty ku është e mundur me u korrigjuar gabimet, ti korrigjojmë. Interesi është i dyanshëm, se mos me qenë, nuk mundesh me këmbyer. Pronat janë të njëjtin kufijtë, nuk ka nevojë për pagesë, por për këmbim të pronave, se ka rrugë apo pjesë të rrugës që është në pronë private dhe ato çështje duhet me i zgjidhur.

z. Selajdin Troni: Të pjesa e raportit sa merr dhe sa jep komuna që e potencoj znj. Kadrije, i ka ra hise qytetarit me marrë me tepër, për me bërë komuna drejtimin e rrugës. Kur një çështje e zgjidhim, edhe pse japim pronë të komunës pak me tepër, nuk ka gjë të keqe këtu, se po bëhet mirë për dy palët.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kjo po i bien me falë një pjesë të pronës së komunës.

Kryetari i Komunës: Ne kemi pasur raste kur kemi marrë me tepër pronë si komunë e kemi dhënë me pak. Një rast ka qenë në lagjen Dallosi.

z. Agim Mani: Nëse e keni analizuar çështjen, znj. Kadrije ishte shumë e qartë. Fillimisht ishte një gabim, mungesa e plotësimit të dokumentacionit bazë, si fleta poseduese. E dyta, me vendosur për 2 parcela në vende të ndryshme me një propozim vendim, kjo nuk është në rregull. Secila shpallje interesi duhet me na ardhur veç e veç, se dikush mundet me qenë i pajtimit për njërën, por jo për tjetrën. Qytetari e ka një kërkesë për 17 m², në ZK në Elezaj, por nuk ka kërkuar këmbim. Unë jam që krejt këto pikë të shtyhen për mbledhjen vijuese. Të kompletohet dokumentacioni, të prezantoj drejtori dhe të prezantohet në ekran këtu këto parcela.

znj. Ardita Rrahmani: Në KPF ne vendosëm me ndarë këtë pikë, se me pas qenë të ndara, kishim vendosur, se unë personalisht për njërën mundem me qenë e bindur, për tjetrën jo.

znj. Kadrije Lika-Troni: Çështja është se nuk është lënda e kompletuar. Nëse ndahen kjo pikë, a shkon e ndarë edhe në MAPL.

z. Naim Beça: Për çka e kemi blerë këtë TV që është këtu në sallë? I kemi blerë, që kur të trajtojmë çështje të pronave, me i pa në ekran.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne diskutuam në KPF me u ndarë, por nuk janë ndarë. Ne mundemi me i ndarë tani në KK. Nëse e ndajmë këtë pikë, në MAPL shkojnë të ndara. Zyrtari i sqaroj çështjet, mundeni me u pajtuar apo jo, është çështje e secilit. A jeni me ndarë këtë pikë? Atëherë e shtoj në votim për aprovim me u nda pika 9 në dy pikë. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Prezentë 23. Në sajë të kësaj del konstatimi se KK vendosi që pika 9 të ndahet në dy pikë. Vazhdojmë me pikën e parë të pikës 9.

9.1 Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Elezaj

z. Agim Mani: Të kërkesa që ka adresuar qytetari për shpallje me interes për 17m2, nuk ka kërkuar as këmbim as shpronësim. A doni me ia këmbyer pronën apo me ia shpronësuar. Nëse ekzekutivi ka kërkesë tjetër, lë ta paraqet.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa për shpallje me interes publik, ka ardhur nga DUKKM. Pajtimi i palëve është, formulimin e ka sjellë DUKKMM. Nëse kjo parcelë shpallet me interes publik, atëherë pason vendimi tjetër. Këtu nuk ka këmbim, por lëndës iu ka bashkëngjitur me atë se pajtohet pala për këmbim, se këmbim nuk ka këtu. Të jemi të qartë, vendimi merret për shpallje interes të pronës, në ZK në Elezaj. Bëhet vlerësimi, pastaj komuna e bien për këmbim ose për pagesë të atyre parcelave. Aty ku është mundësia për këmbim, është me lehtë, se komuna nuk paguan.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pse mungon drejtori kur kemi këso lloj çështje dhe pse mungon kopja e planit dhe fleta poseduese?

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është jashtë vendit. Atëherë propozimin për shpallje me interes të pronës në ZK Elezaj e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua n 16 votë Për, Kundër ishin 7 anëtarë të LVV. Abstenim nuk ka. Prezentë 23. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Elezaj/ Lënda: 01Nr. 350/05-3980/25.

9.2 Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Bob;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimin Vendimin për shpallje me interes të pronës në ZK Bob e shtroj e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua n 14 votë Për, Kundër ishin 7 anëtarë të LVV. Abstenim 2 (Ardita Rrahmani, Arlinda Rakoci-Raka). Prezentë 23. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në ZK Bob/ Lënda ka marrë numër të protokollit: 01-60/01-5244/25.

10. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të pjesëve Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe ky Propozim vendim është për shpallje me interes publik. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Në orto foto shihet se rruga Emsale Frangu përfundon të këto parcela, me dokumente kadastrale është rrugë pa krye. Në terren gjendja e kësaj rruge është krejt ndryshe, sepse kjo është asfaltuar dhe vazhdon deri të pronat e familjes Zharku, gati në 300m. Ky propozim që e ka sjellë drejtori i urbanizmit së bashku me kryetarin, nuk ka kuptim dhe nuk është në të mirën e përgjithshme, por është me i mbuluar veprimet e kundërligjshme, që i kanë bërë në vitet e kaluara, sidomos në vitin 2024, ku keni punuar trotuare dhe mure nëpër këto prona, pa asnjë vendim komunal, pa respektuar procedura ligjore, duke e dëmtuar parane publike. Krejt këto punë i keni kryer pa pasur ndonjë projekt detal të kësaj rruge, dhe pa e zgjidhur çështjen pronësore të pjesës tjetër të rrugës, nga shkolla deri të prona e familjes Zharku. Propozimet e tilla selektive në dëm të pronës komunale, të aprovuara në vitin e kaluar, e dini se janë refuzuar nga ministria në shqyrtimin e ligjshmërisë. Pyetje kryetarin dhe drejtorin e DUKMM: Pse po bëni veprime të njëjta, duke i përsëritur gabimet? Pse po e vëni në sprovë dhe lajthitje KK, në çështje të tilla, të cilat përsëri do të refuzohen nga ministria, sepse nuk keni asnjë dokument paraprak të planifikimit urban apo projekt detal të kësaj rruge që mundëson fillimin e këtyre procedurave për shpallje me interes të përgjithshëm të këtyre parcelave. Nga planet urbane e projekti detal, mund të shihet sesi do të shtrihej kjo rrugë gjeometrikisht dhe si do të duhej të ndërtohej. Këto orvatje të juaja, janë vetëm mashtrime që mundoni me i mbuluar gabimet nga paslufta, duke lejuar ndërtime që kanë bllokuar pronën publike edhe në këtë rrugë. Drejtori nuk është këtu, ka qenë drejtor edhe në atë kohë kur janë bërë parregullsi ndërtimore e urbane. Ky propozim arbitrar është kuturu, pa asnjë studim e analizë paraprake, pa asnjë matje gjeodezike për përcaktimin në mënyrë profesionale të trajektore të rrugës në përgjithësi, matjet sipas të cilave do të caktoheshin edhe uzurpimet e pronës publike. Ju me paramendim, jeni duke bërë veprime të qëllimshme kundërligjore, po doni t'i mbulonit me vendime të KK në mënyrë të pandershme, të pasinqertë dhe proceduralisht kundër dispozitave ligjore, sepse interesi i përgjithshëm komunal, këtu nuk ekziston.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e kam të qartë logjikën e juaj, kur thoni janë shtruar rrugë dhe trotuare që nuk i shërbejnë të mirës së përgjithshme. Ju mundeni me qenë me mirë i informuar për atë punë, se unë nuk e di, por rrugët dhe trotuaret, muri mbrojtës, këto i shërbejnë të mirës së përgjithshme. A është bërë mirë apo keq ajo rrugë, mundemi me diskutua.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të mirat e përgjithshme bëhen me taksa të qytetarëve, nën menaxhimin e komunës. Në momentin kur hartohet një plan i asaj rruge, normal se është interes i përgjithshëm i banorëve që frekuentojnë në atë rrugë. Ndërtohet shkolla, ndërkaq nuk është e zgjidhur çështja e rrugës. Kur ndërtohen mure dhe trotuare, qysh ndërtohen në prona ende të parregulluara. Në vitin e kaluar janë kryer ato punime, është fjala se po përsëriten gabimet. Ne po flasim tërë kohën me u përmirësuar, ju prapë gaboni. Kjo është esenca, se po dëmtohet paraja publike. Për me u zgjeruar rrugët, normal se është me i madh interesi publik, sesa interesi personal.

Kryesuesi i Kuvendit: Me herët nuk e potencove kështu.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kështu e theksova, por me keni keqkuptuar.

z. Rufat Muqa- zyrtar në DUKMM: Për rrugën në fjalë, zgjerimi është bërë në anën e epërm, ku ka pasur uzurpime, ju kanë marrë pronat komplet deri të shtëpitë dhe është rregulluar trotuari. Kurse kjo pjesa që po shpallet me interes, është në anën e poshtme, ku ekzistojnë muret që janë nga paralufte, e jo pas lufte e as në kohën e Besim Ilazit.

z. Burim Shehu: Për cilën pjesë e keni fjalën për muret që janë ndërtuar paralufte, se ka shumë që janë ndërtuar, asnjë nuk janë paslufte. Kjo pjesa ku po doni ju me i kryer këto punë, janë edhe 5 shtëpi përpara, rruga është me e ngushtë se këtu në anën e epërme ku po doni me e kryer, dhe ju keni filluar prej gjysmës e përpjetë, ndërkaq janë edhe 5 shtëpi përpara.

z. Rufat Muqa: Poshtë ku po thoni Burim se është rruga me e ngushtë, është Sami Jahës i cili ka marrëveshje, Minyri (i ndjerë tanimë), pasi ka bërë marrëveshje na ka dhënë tokën pa

kompensim dhe e kemi ndërtuar murin deri në skaj të shtëpisë së tij, ndërkaq për këto tjera përjetë që nuk kemi marrëveshja në vazhdim, shpallen, kjo është prona e Gynërit.

z. Burim Shehu: Për mbi shtëpinë e Sami Jahës janë edhe dy shtëpi.

z. Rufat Muqaj-zyrtar në DUKMM: Projekti është edhe kah ajo pjesë, edhe atij ia kemi marrë pronën komplet, që e ka prishur duvarin, Shaqirit. I di në detaje se kam qenë menaxher i projektit. Kurse Gynërit, Ylber Tirollit, Skender Tirollit, Emrush Qallakut dhe Fikrije Bajrami, a janë murët e paralufte?

z. Burim Shehu: Po.

z. Agim Mani: Ne jemi duke folur për një projekt që është kryer në vitin e kaluar, pa u kryer procedurat paraprake. Fillimisht është dashur me u kryer procedurat paraprake, si shpallja e interesit et.

z. Selajdin Troni: Çka është duke të penguar kjo punë Agim. Edhe tani i shpallim ato prona me interes. Nuk mundem me iu dëgjuar gjysmë ore, dy herë keni të drejtë me marrë fjalën.

z. Agim Mani: Ne jemi duke debatuar, kush mundet me dëgjuar, mundet me dalë jashtë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ne jemi duke debatuar. Kush jeni ju që nuk doni me na dëgjuar?

z. Agim Mani: Ne e thamë më herë se jemi duke u marrë me një projekt që është kryer në vitin e kaluar, pa i marrë hapat paraprak si institucion, ndërkaq tani po diskutojmë pas një viti për ato veprime që është dashur me i marrë paraprakisht.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë kam pak njohuri për atë çështje, por zyrtari të shpjegoj shumë qartë se në cilën pjesë është marrë prona në vitin e kaluar dhe në cilën pjesë tani. A pajtoheni që rruga ka nevojë për zgjerim, ka nevojë?

z. Agim Mani: Rruga ka nevojë me u zgjerua deri në fund, e jo dike me dëmtuar dike jo.

Kryetari i Komunës: Kërkesa ka qenë për zgjerimin e asaj rruge, se ka qenë shumë e ngushtë. Kërkesa ka qenë emergjente me zgjeruar atë rrugë, ndërkaq ju po thoni se nuk i keni marrë veprimet paraprake, pastaj me zgjeruar rrugën. Çështja është se ka qenë situatë emergjente, për 700-800 nxënës, ka qenë e kuptueshme dhe është bërë. Sa ka pasur hapësirë me u zgjeruar, për shkak të shtëpive, ne e kemi shfrytëzuar maksimumin, se kam qenë vet një 10 herë atje. Po me habitë sot diskutimi i juaj. Kushdo që nuk donë me u bindur, nuk bindet, por ajo pjesë, është mbi 1 ari, kufijtë janë vendosur para vitit 1999. Dhe në momentin që ka lindur nevoja emergjente me zgjeruar, kemi marrë veprime, për një pjesë është bindur pala dhe e ka dhënë pronën, një pjesë është kompensuar me këmbim, prona e Shaqirit. Të pjesa e këtyre tjerëve, nuk janë bindur, i kemi pasur në zyre, dhe i kemi thënë se do i udhëheqim procedurat. Në kohën kur është ndërtuar rruga, nuk kemi mundur me i kryer këto, se edhe kod e kemi pas paraparë zgjerimin e asaj rruge. Mos e merrni shumë tragjike, se nëse mendoni se ka parregullsi, janë organet kompetente që merren me këtë punë. Ju inkurajoj për këtë dhe çdo herë kur mendoni se ka parregullsi, lajmëroni organet, sepse edhe unë ndihem me rehat.

znj. Kadrije Lika-Troni: Fillimisht është dashur me u kryer procedurat paraprake.

Kryetari i Komunës: Ju jeni duke me kthyer në vitet para 30 viteve, se nuk po e dimë këtë për veprimet paraprake që duhet me i marrë. Kur nuk doni me votuar, nuk është puna veç me fol diçka.

z. Selajdin Troni: Ju e dini se qysh kemi dal prej lufte me 100 mijë probleme, tani ne kemi arritur deri në atë pikën me i rregullua, për ju e kam Kadrje me ua sqaruar.

znj. Ernesta Krasniqi: Askush nuk kërkoj nga ju sqarim Selajdin.

z. Selajdin Troni: Aty janë ndërtuar shtëpi paslufte, kanë qenë parcelat e pabanueshme, pa shtëpi. Qysh mundemi tani me ua prishur shtëpitë me zgjeruar rrugën, kur ata nuk kanë fare interesim?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne u munduam me sqaruar këtë çështje. Diskutime të tjera nuk ka, kjo pikë u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër ishin 6 nga LVV. Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik të pjesëve Parcelave kadastrale në ZK Kaçanik/Lënda: 01Nr.350/05-3986/25.

11.Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Kumrije Tali;

Kryesuesi i Kuvendit: Këto çështje i kemi trajtuar edhe me herët në KK, ndërkaq nga ministria është kërkuar me u bërë vlerësimi i pronave. Vlerësimi është bërë nga ministria e Financave dhe na ka ardhur. Tani duhet të merret vendimi përfundimtar. Kur lënda të shkon në shqyrtim të ligjshmërisë, i bashkëngjitet edhe vlerësimi që e ka bërë ministria e Financave me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Ky propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme, është në tërësi në dëm të komunës, sepse prona private PK 01965-2 është në pjesën e thellë kodrinore të qytetit të Kaçanikut, në pjesën verilindore, mbi lagjen Bela, që gjendet në rrugën ‘Selim Shehu’ në Kaçanik, në distancë në vijë ajrore gati 1 km nga pronat komunale të propozuara për këmbim. Këtu ka vetëm interes privat nga dikush në komunë dhe përfitim të pronës private. Asnjë interes komuna nuk ka në PK 01965-2, sepse në këtë pronë nuk ka rrugë publike, siç paraqitet nga DUKMM. Nga orto foto siç shihet majtas, rruga kalon në skaj të kësaj parcele dhe nuk ndërhyjnë fare në PK 01965-2 të Kumrije Tali. Situacioni i dërguar nga DUKMM është tendencë për mashtrim të KK, dihet edhe fakti se këto parcela janë diametrisht në anë të kundërta të qytetit të Kaçanikut. Edhe vlerësimet e ministrisë dërguar me këtë material, janë vetëm tendencë për me paraqitur jo seriozitetin në këtë këmbim, dhe si e tillë komuna nuk ka asnjë interes dhe ky vlerësim nuk është i nevojshëm. Pronat komunale të propozuara për këmbim, janë në anën e majtë të kryqëzimi i rrugës “Avdurrahim Shehu”, në rrugën e f. Llanishtë, dhe të njëjtat janë propozuar për këmbim edhe në vitin e kaluar dhe nuk kanë kaluar. Në këto prona ka ndërtime të cilat kanë bërë uzurpime të pronave komunale dhe sigurisht DUKMM ka tendencë përfitimi në emër të tij, sepse realisht nuk do të duhej të propozohej e lerë më të këmbehej, duke mashtruar KK. Kryetar, në pikët, 2.1, 2.2, 2.3, PK 01271-0, 01772-1, 01274-1 thuhet se vendndodhja e pronave komunale janë rrugën “Mukadeze Lika-Muhaxheri, kjo është e pavërtetë, sepse këto parcela shtrihen përgjatë rrugës “Avdurrahim Shehu”, dhe “Esat Axhami”. Këtu edhe emri i rrugës është gabim.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është trajtuar në KK dhe ka shkuar në shqyrtim të ligjshmërisë, është kthyer për shkak se nuk e kemi pasur vlerësimin e ministrisë nga ministria e Financave dhe Agjencioni Kadastral. Tani vlerësimi ka ardhur nga këto organe, lënda është e kompletuar, vlerësimin e kanë bërë organet kompetente, me këtë punë është marrë krejt një palë e tretë, ndërkaq për emrat e rrugëve nuk e di, ndërkaq për çështjen e vlerësimit a ia vlen apo jo, është marrë dikush tjetër me këtë punë, ashtu qysh vjen vlerësimi, ne e trajtojmë.

z. Visar Mulaku: Të njëjtën që e potencuat kryeses, pata me thënë edhe unë. Vlerësimin e ka dhënë ministria e Financave, vlerësimi është bërë për dy pronat.

znj. Kadrije Lika-Troni: Emri i rrugës në gjeoportal është gabim.

z. Visar Mulaku: Ne jemi bazuar në dokumentacion, nëse është gabim, e korrigjojmë.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse është gabim emri i rrugës, në vendim e korrigjojmë. Diskutime të tjera nuk ka, kjo pikë u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 13 votë Për

Kundër ishin 6 nga LVV. Abstenime 2 nga LDK (Arlinda Rakoci-Raka, Besnik Salihu).
Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Kumrije Tali/ Lënda: 01Nr. 104/02-4019/25.

12.Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Adnan Vishi;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe këtë çështje e kemi pasur në trajtim në KK, është shpjeguar edhe atëherë cili është arsyetimi dhe marrëveshja. Është bërë tani vlerësimi i këtyre pronave. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër 6 anëtarë të LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 21. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Adnan Vishi/Lënda: 01Nr. 104/02-4021/25.

13.Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Burim Çallaku;

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe këtë çështje e kemi pasur në trajtim në KK. e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Pjesa e parcelës 00101-0, që propozohet me u këmbyer me pjesën e pronës private, që në fakt qëllim ka legalizimin e objektit të ndërtuar në pronën publike, një pjesë të tij, përderisa prona private ku është dashur me u ndërtuar shtëpia, ka sipërfaqe me të madhe. Propozimi në tërësi është i paarsyeshëm dhe i padobishëm për interesin publik, sepse ngushtohet hapësira publike në pozicionin e propozuar. Kjo rrugë për f. Gajre, nuk e ka të rregulluar çështjen pronësore, dhe propozime të tilla janë vetëm për interesa të ngushta. Është me rëndësi të cekët fakti, si ka lindur kjo iniciativë, ku pronari nuk ka bërë kërkesë, ndërsa DUKMM nisë procedurë për këmbimin e atyre pronave. Çështja pronësore në një pjesë të madhe të rrugës së f. Gajre, është e pa definuar, ndërsa sa përket dokumenteve për vlerësimin e pronave për këmbim, pa u marrë vendimi i KK, është punë e kotë, kjo bëhet sa për të bindur KK kinse në seriozitet e veprime të marra nga DUKMM, që në fakt janë veprime të pamenduara dhe të dëmshme për pronën publike komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe atëherë e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër 5 anëtarë të LVV, Abstenim nuk ka. Prezentë 20. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik, Burim Çallaku/ Lënda: 01Nr. 104/02-4023/25.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 15:45. Nga 27 anëtarë të KK sa ishin pjesëmarrës fillimisht në mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 20 anëtarë. Në pjesën e dytë të mbledhjes -nga pika 4 nuk ishin: Raif Kasa, Betim Shala, Agim Çaka, ndërkaq Kadri Krivenjeva nga pika 9, Ardita Rrahmani, nga pika 10, Agim Mani në përfundim të pikës 10, Naim Beça në përfundim të pikës 13.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 13.03.25	Vendi KAÇANIK
Uj. org.	Numri	Shtojcë
04	610/01-5847	/



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Ne baze të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) te Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika I, te Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) te Ligjit për Arsimin ne Komunat Republikës se Kosovës Nr.03/L- 068, te nenit 6 pika 3 paragrafit I, Neni 14 Përbërja e komisionit përzgjedhësme paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Rregullore (QRK) - Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimmshënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit me datë 10.03.2025 nxjerr këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore

1. Me këtë propozim-vendim, Drejtoria e Arsimit (DA) kërkon nga Kuvendi Komunal emërimin e Komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për pozitën Drejtor dhe Zëvendës drejtor të institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik, SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec dhe SHFMU "7 Shtatori" në Begracë, në këtë përbërje:

- 1.1 Gafurr Guri, Kryetar i komisionit, drejtues i ulët në DA;
- 1.2 Florie Zeneli - Berisha, Anëtare, drejtoreshe në SHFMU "Idriz Seferi"; dhe
- 1.3 Nje(l) përfaqësues i MASHTI-të, anëtar.

2. Komisioni përzgjedhës është ad hoc dhe mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve në pozitën e kërkuara me konkurs.

3. Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Rregullore (QRK) - Nr.19/2024.

4. Me këtë propozim - vendim njoftohet Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Anëtarët e propozuar.



z. Zahir Doda

Drejt. i Drejtorisë së Arsimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

**Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit
dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Kaçanikut duke u bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, neni 5, paragrafi 1.2; në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 17, bën këtë:

Propozim

Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, që lidhur me kërkesën e z. Gzim Dema nga Bobi, për ndërrim destinimit të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa Nr.06-350/02-5644/25, e datës 10.03.2025, e parashtruar nga z. Gzim Dema, me banim në Bobi, për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, me sipërfaqe prej **1379m²**. Siperfaqja e tokës e paraparë për ndërrim destinimi ka nr.e parcelës kadastrale P-70917008-00177-1, vendi i quajtur “Ara e Alimit”, në Zona Kadastrale Bob, me kulturë bujqësore - arë e klasës 3, me sipërfaqe totale 1379m², e cila sipas shënimeve të Zyres Kadastrale të Komunës së Kaçanikut është në posedim të nënës së parashtruesit të kërkesës, znj. Shahe (Ilaz) Dema nga fsh. Bob.

Ndrrimi i tokës bujqësore në ndërtimore bëhet për krijimin e kushteve për ndërtim. Sipas Planit Zhvillimor Komunal kjo parcelë është e destinuar për bujqësi.

Arsyetim

Në Drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit më 10.03.2025, ka arritur kërkesa me numër 06-350/02-5644/25 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë bujqësore-arë e klasës 3, në tokë ndërtimore.

Komisioni për shyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit më 10.03.2025 i ka rekomanduar DUKMM-së për lejimin e ndërrimit të destinimit duke u mbështet në atë se z. Gzim Dema nga fshati Bob do të investojë në ndërtim.



 REPUBLIKA E KOSOVËS	0101 - Formulari për kërkesë apo ankesë	 KACANIKU
Drejtorati / Njesia DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTER DHE MBROJTJE E MJEDISIT		Data <u>10.03.2025</u> (dita / muaji / viti)

1 Informatat personale të parashtruesit të kërkesës:			Mos shkruani në Pranuar nga: Numri i protokollit: <u>06-35062-5644/25</u> Vendimi: po Nga: Data:
Emri dhe mbiemri <u>SHAFIE DEMA</u>	Lloji dhe numri i dokumentit identifikues <u>1004957071</u>		
Data e lindjes (dita / muaji / viti)	Adresa e vendbanimit <u>BOB</u> (numri i shtëpisë/banesës, ruga, fshati/qyteti, kodi postar)		
Numri i tel. fiks	Numri i tel. mobil <u>044 353 882</u>	E-mail adresa	

2 Selektu llojin:

Kërkesë



Ankesë




3 Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kërkojë nga DOKUMENT Lejimin e molimit të
Dëftimit për Parcelën kadastrale Nr. 177-1 nga
fotokopjime në molimim.

4 Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Gzim DEMA
(Emri i plotë i aplikuesit)

vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.


(Nënshkrimi)

*** Ju lutemi të kërkontë nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura ***



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917008-00177-1

5641/2025

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

10.03.2025 - 14:23

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Komuna / Opština / Municipality:

Bob / Bob / Bob

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917008-00177-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	1379	47-1983	08.02.2016	08.02.2016

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ARA ALIMIT			08.02.2016	08.02.2016



A.2 LLOJI I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klasse/3rd Class Arable Land	1379

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	DEMA SHAHE (ILAZ)	1004957071	BOB / BOB / BOB /		VËLLEZERIT DEMA	1/1	RIK, AKTV KOMISONIT NR. 09-43-2015 DT. 18-12-2015, PROCESVERBAL NR. 09-43- 2015 DT. 13.11.2015	09.02.2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Komisioni për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

DATE:	10.03.2025
REFERENCE:	06Nr.350/02-5644/2025
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1.Mustafë Loku 2.Rakip Vishi 3.Arditë Shehu
TEMA:	Proqesverbal lidhur ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në parc. 00177-1

I përpiluar më datën 14.03.2025 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-5644/25 të datës 10.03.2025 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së të z. Gzim Dema nga fshati Bobë, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore .
Me kërkesë e palës komisioni doli në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar siç vijon :

-Prona e propozuar për ndërrim të destinimit, parcela kadastrale nr.00177-1 me kulturë arë i kl.3 në zonë Urbane në ZK-le Bob, vendi i quajtur "Ara e Alimit " rruga " Vëllezrit Çaka", ka sipërfaqe prej 1379m² e evidentuar në çerifikatë të pronës me nr.5641/25 të datës 10.03.2025 dhe kopjen e planit, në Zonën kadastrale Bob, në posedim të z.Shahe (Ilaz) Dema nga fshati Bob.

- Verifikon se parcela në fjalë gjindet zonën kadastrale Bob në vendin e quajtur "Ara e Alimit " pranë rrugës "Vëllezrit Çaka"dhe me PZHK është Tonë Bujqësore.

Komisioni i rekomandon DUKMM-së që në parcelën e lartëcekur të lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pjesën parcelës kadastrale nr. 00177-1 me sipërfaqe prej 1379m², me kultur arë e klasit 3.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Komisioni për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

DATË:	10.03.2025
REFERENCE:	06Nr.350/02-5644/2025
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1.Mustafë Loku 2.Rakip Vishi 3.Arditë Shehu
TEMA:	Proqesverbal lidhur ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në parc. 00177-1

I përpiluar më datën 14.03.2025 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-5644/25 të datës 10.03.2025 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së të z. Gzim Dema nga fshati Bobë, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Me kërkesë e palës komisioni doli në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar siç vijon :

-Prona e propozuar për ndërrim të destinimit, parcela kadastrale nr.00177-1 me kulturë arë i kl.3 në zonë Urbane në ZK-le Bob, vendi i quajtur “Ara e Alimit “ rruga “Vëllezrit Çaka”, ka sipërfaqe prej 1379m² e evidentuar në çerifikatë të pronës me nr.5641/25 të datës 10.03.2025 dhe kopjen e planit, në Zonën kadastrale Bob, në posedim të z.Shahe (Ilaz) Dema nga fshati Bob.

- Verifikon se parcela në fjalë gjindet zonën kadastrale Bob në vendin e quajtur “Ara e Alimit ” pranë rrugës “Vëllezrit Çaka”dhe me PZHK është Tonë Bujqësore.

Komisioni i rekomandon DUKMM-së që në parcelën e lartëcekur të **lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pjesën parcelës kadastrale nr. 00177-1 me sipërfaqe prej 1379m², me kultur arë e klasit 3.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Komisioni për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

DATË:	10.03.2025
REFERENCE:	06Nr.350/02-5644/2025
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1.Mustafë Loku 2.Rakip Vishi 3.Arditë Shehu
TEMA:	Proqesverbal lidhur ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në parc. 00177-1

I përpiluar më datën 14.03.2025 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-5644/25 të datës 10.03.2025 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së të z. Gzim Dema nga fshati Bobë, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore . Me kërkesë e palës komisioni doli në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar siç vijon :

-Prona e propozuar për ndërrim të destinimit, parcela kadastrale nr.00177-1 me kulturë arë i kl.3 në zonë Urbane në ZK-le Bob, vendi i quajtur "Ara e Alimit " rruga "Vëllezrit Çaka", ka sipërfaqe prej 1379m² e evidentuar në çerifikatë të pronës me nr.5641/25 të datës 10.03.2025 dhe kopjen e planit, në Zonën kadastrale Bob, në posedim të z.Shahe (Ilaz) Dema nga fshati Bob.

- Verifikon se parcela në fjalë gjendet zonën kadastrale Bob në vendin e quajtur "Ara e Alimit " pranë rrugës "Vëllezrit Çaka"dhe me PZHK është Tonë Bujqësore.

Komisioni i rekomandon DUKMM-së që në parcelën e lartëcekur të **lejohet ndërrimi i destinimit** të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pjesën parcelës kadastrale nr. 00177-1 me sipërfaqe prej 1379m², me kultur arë e klasit 3.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Bob

941-588225

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917008-00177-1	Parcelë / Parcela / Parcel	1379



Shkalla/Razmera/Scale: 1:439

Punoi/Obradio/Created: Mentor Shehu

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 14.03.2025

Koha/ Vreme/ Time: 09:00:20



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPSTINA KAÇANIK		
11.05.2025 Vendi KAÇANIK		
Numri	Shtojcë	
01	60/01-5878 V.	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

**RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
PËR VITIN 2024**

Kaçanik, Mars 2025

PËRMBAJTJA:

1.HYRJE

2.PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

3. AKTIVITETI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

4. ÇËSHTJET E SHQYRTUARA NGA KPF

4.1 Aktet normative

4.2 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Kaçanikut 2025-2027

4.3 Propozim Buxheti i komunës për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 -2027

4.4 Raportet finaciare dhe Planet e veprimit

4.5 Propozim Vendimet për çështje financiare

4.6 Propozim Vendime tjera me rëndësi për komunën

4.7 Propozim Vendimet për shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të komunës

4.8 Propozim Vendime për formim të komisioneve

4.9 Propozim Vendimet për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

4.10 Panet e Punës dhe Raportet e punës

4.11 Çështjet të tjera me rëndësi për komunën

5. SEKTORI I KUVENDIT

6. PËRFUNDIM

1. HYRJE

Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF është trupë e përhershme punuese i Kuvendit të Komunës, është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-38152/21 më datë: 29.12.2021, prej 7 anëtarëve, në këtë përbërje:

1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.

Kjo përbërje pëson ndryshime, pas dorëheqjes së anëtarëve: Fitore Vishi dhe Rabije Sallahi nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, me çka me automatizëm iu ka pushuar pozita e anëtarit në Komitetin për Politikë dhe Financa. Zëvendësimet në KPF janë bërë me vendime të Kuvendit të Komunës: 1. Vendimit: 01 Nr. 60/01-14084/24 me datën 28.06.2024, në vend të Fitore Vishi, caktohet, Rrustem Zenuni-PDK. 2. Vendimit: 01 Nr. 060/01-23022/24, me 30.09.2024, në vend të Rabije Sallahu, caktohet, Edona Luzha-AAK.

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës. Me Komitetin për Politikë dhe Financa, udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli, sipas funksionit që ka. Mandati i KPF-së është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

2. PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Sipas nenit 52.2 të Ligjit Nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale, KPF-a është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesëm, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore të tarifave dhe ngarkesave, planin vjetor të punës së auditimit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit të komunës gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga kryetari i komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

3. AKTIVITETI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Sipas Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës, Rregullores për punë të Kuvendit të Komunës, KPF-a për gjatë periudhës raportuese është munduar që në suaza të kompetencave të veta t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar. Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në takime të rregullta mujore. Ftesa për mbledhje bashkë me materialin i është dërguar paraprakisht të gjithë anëtarëve të KPF, Ekzekutivit të Komunës, Zyrës së Informimit, Zyrës së IT. Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta nga 12 të planifikuara. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive. Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Prezenca e anëtarëve të këtij komiteti ka qenë e rregullt, me përjashtim të ndonjë mungese shumë të arsyeshme. Nuk ka pasur lëshim apo bojkotim të asnjë mbledhje apo pjesë të mbledhjeve. Në mbledhjet e KPF-së ka mbretëruar një frymë e punës dhe e bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur Procesverbal i cili pas aprovimit të KPF është bërë transparent në faqen zyrtare të

komunës. Në takimet e KPF-së janë shqyrtuar çështje të ndryshme në interes të komunës apo në interes të personave fizik dhe të personave juridik. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatohet Kuvendi i Komunës në seancën e vet, kjo trupë punuese paraprakisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ka shqyrtuar 74 çështje për të cilat ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim apo marrjen e vendimit adekuat. Në disa takime të kësaj trupe punuese ka marrë pjesë Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, ndërkaq kryesisht drejtorët e Drejtorive Komunale, të cilët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushë veprimtarisë së tyre, pasi që gati çdo çështje ka shqyrtuar KPF, propozimet kanë rrjedhur nga organi ekzekutiv i komunës. Ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe informacione tjera të nevojshme shtesë drejtpërdrejtë në mbledhje.

Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndërkombëtarë gjatë periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. I gjithë materiali i mbledhjes i është dërguar OSBE, disa nga mbledhjet janë monitoruar nga Faruk Dërmaku, ndërkaq në një mbledhje ishte në monitorim edhe nga Arben Shehu.

Mbledhjet e KPF-së janë mbajtur me dyer të hapura për çdo të interesuar, mirëpo pjesëmarrja e qytetarëve, OJQ dhe grupeve tjera të interesit ka qenë minimale. Për aktivitetin e zhvilluar të KPF-a është bërë një përmbledhje e punimeve dhe i njëjtin është plasuar në faqen zyrtare të komunës dhe në facebookun zyrtar të komunës. Ftesa për mbledhje të KPF me materialin përkatës është publikuar çdo herë në faqen zyrtare, ndërkaq në facebookun zyrtar të komunës është publikuar ftesa për mbledhje. Kjo tregon sesa ka qenë transparente kjo trupë punuese ndaj qytetarëve të komunës, OJQ-ve dhe grupeve tjera të interesit për aktivitetin e saj të zhvilluar përgjatë periudhës raportuese.

4. ÇËSHTJET E SHQYRTUARA NGA KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej 85 pikë, përfshirë edhe Procesverbalin e mbledhjes së KPF (11 procesverbale) që ka qenë pikë e parë e rendit të punës në çdo mbledhje. Në krahasim me vitin 2023, KPF në vitin 2024 ka pasur në shqyrtim 6 pikë më tepër. Çështjet e shqyrtuara janë materiale të përgatitura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës. Çështjet e shqyrtuara kanë qenë të natyrave të ndryshme, janë shqyrtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregullativen normative-draft statute, çështje buxhetore, raporte dhe programe të punës së ekzekutivit të komunës, propozim vendime të ndryshme të shërbimeve përkatëse profesionale, dhe çështje tjera më rëndësi për komunën. Bazë për hartimin e këtij raporti janë, procesverbalet e mbledhjeve të KPF të vitit 2024. Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa:

4.1 Aktet normative

Gjatë periudhës raportuese përmes KPF nuk është adresuar ndonjë rregullore, ndërkaq aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të kësaj trupe punuese janë: Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Draft Statuti i Muzeut të qytetit të Kaçanikut. KPF i ka shqyrtuar në detaje këto akte normative dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim apo në procedurë të mëtutjeshme të debatit publik me qytetarë të komunës.

4.2 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Kaçanikut 2025-2027

Si çdo herë tjetër kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2024 KPF-a i ka kushtuar rëndësi të veçantë, Kornizën afatmesme të shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për vitet: 2025-2027. Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Dokumente përcjellëse që i kanë paraprirë hartimit të buxhetit për vitin 2025 janë:

Qarkoret e brendshme buxhetore dhe KBAK. Vetëm për Draftin kornizë KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë, e ka dhënë mendimin e vet dhe ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim apo lëshimin e dokumentit në procedurë të debatit publik me qytetarë. Kur jemi të debatet publike, KPF ka mbajtur një debat publik me qytetarë për draftin kornizë, me 19 qershor 2024, për të cilin është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në faqen zyrtare të komunës. Vlen të përmendet se pjesëmarrja qytetarëve, OJQ dhe grupeve të interesit në këtë debat publik ka qenë shumë e kënaqshme

4.3 Propozim Buxheti i Komunës për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 -2027

Në këtë dokument, KPF-a ka shqyrtuar Buxhetin afatmesëm të projektuar të komunës për vitet: 2025-2027, ka aprovuar Propozim Buxhetin e Komunës për vitin 2025 në shumë, 12,592,239.00€ dhe Vlerësimet për vitet 2026-2027, në shumat buxhetore, 13,193,668.00€ dhe 13,809,572.00€ për vitin 2027. Edhe në këtë plan afatmesëm buxhetor, KPF-a ka propozuar me i futur synimet e veta për secilën veprimtari konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, dhe çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale. Në këtë drejtim ka aprovuar një Listë me 46 Projekte Kapitale të propozuar nga ekzekutivi i komunës, duke iu dhënë prioritet atyre projekteve që janë me të nevojshme dhe emergjente për komunitetet në shumën, 3,473,583 €. Duke marrë për bazë faktin se më buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara, sepse disa nga projektet kanë hyrë në listë vetëm sa për t'u koduar, mirëpo gjithherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe më gjerë për gjetjen e donacioneve më qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në dëgjime publike të organizuara me qytetarë, ku një dëgjim publik për çështje të buxhetit të komunës, është organizuar nga kjo trupë punuese me 17 shtator 2024, për të cilin është mbajtur procesverbal dhe i njëjti është publikuar në faqen zyrtare të komunës. Vlen të përmendet se pjesëmarrja qytetarëve, OJQ dhe grupeve të interesit në këtë debat publik ka qenë shumë e kënaqshme. Pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, Draf Buxheti i Komunës për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitin 2026-2027, i është përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

4.4 Raportet financiare dhe Planet e veprimit

Gjatë periudhës raportuese, KPF ka shqyrtuar këto raporte që lidhen me çështjet financiare:

1. Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023;
2. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar – Dhjetor 2023;
3. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023;
4. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;
5. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;
6. Raporti gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;
7. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;
8. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023;
9. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024.

Të çështja e raporteve financiare, KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat në pajtim me planifikimin e të hyrave vetjake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport më planifikimin ka qenë më pak i kënaqur dhe këto pakënaqësi kjo trupë punuese i ka shprehur sa herë të ekzekutivi i komunës dhe sugjerimet e KPF-a kanë ndikuar në një angazhim pak më të

madh të sektorëve të caktuar që inkasimi i të hyrave vetjake komunale në sektorë të caktuar të shënoj ngritje. Në Raportet financiare, vlen të cekët se KPF-a ka kërkuar sqarime shitesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka pasur paqartësi, ndërsa për çdo shpenzim që ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport më nevojat të tjera, ka dhënë vërejtjet e tija, ndërkaq i ka mbështetur rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura si në raportin e vitit 2023. Në këtë drejtim ka aprovuar Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në raportin e auditimit të dhënë nga ZKA, për vitin 2023. Për të gjitha raportet e sipërshënuara, pas shqyrtimit të thukët, KPF ia ka përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

4.5. Propozim Vendimet për çështje financiare

Propozim Vendimeve për çështje financiare, KPF-a iu ka kushtuar një rëndësi e veçantë, në këtë drejtim në pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale apo çështje të tjera, është intervenuar në mjetet që nuk kanë arritur të realizohet sipas Listës së projekteve kapitale nga vitet paraprake, për t'i bartur në ndonjë projekt tjetër kapital. Në këtë drejtim ka aprovuar Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024; Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2024; Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore nga burimi i fondeve 22 - të hyrat e bartura nga viti kaluar 2023 në buxhetin e vitit 2024, Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024, Propozim Vendim për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2024, Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Vendimi për bartjen e të hyrave të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024 ka ndikuar në ndryshimin e buxhetit të vitit 2024. Ndërkaq, me qëllim që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit, KPF ka aprovuar Propozim Vendime për rialokimin të mjeteve, transfer, transferin mjeteve e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2024.

Nga çështje tjera financiare, KPF ka shqyrtuar, Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut; Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut, Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024; Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar Nr. 08-320/01-11894/24 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e breshërit në territorin e komunës së Kaçanikut, në Llanishtë dhe Kotlinë, Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr. 320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj – Gabrricë.

Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPF-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka ardhur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar. KPF pos tjerash ka kërkuar në vazhdimësi sqarime të nevojshme nga ekzekutivi i komunës se deri ku kanë arritur realizimi i projekteve kapitale. Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPF-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar, Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre.

4.6 Propozim Vendime tjera me rëndësi për komunën

Propozim vendimet e propozuara kryesisht janë të natyrave të ndryshme me rëndësi për komunën. Në këtë drejtim ka aprovuar, Propozim Vendim për realizimin e një vizite zyrtare studimore e anëtarëve të Kuvendit dhe të Ekzekutivit të komunës Kaçanik, jashtë vendit - në

një nga vendet e rajonit; Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë; Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut; Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së Veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale, Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte), Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite; Propozim Vendim Paraprak Për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatshkurtër për 15 vite, Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11398/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Doganaj, ofertuesit ROYAL BENVÉRAGE LLC;

Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11401/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit X Pro Inovation LLC, Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11400/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Koxhaj, ofertuesit Suad Koxha, Rekomandimi i komisionit vlerësues 01Nr. 104/02-11403/24 -për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në Zonën Kadastrale Kotlinë, ofertuesit ECO-EXCLUSIV Sh.P.K; Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Mevlud Zharku, Propozim Vendimi për shkëputjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik "KAÇINKA" L.L.C. Është njofuar me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T –DIAP për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik.

Për të gjitha këto çështje, KPF ka diskutuar, e ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka ka përcjellë Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim apo njoftim.

4.7 Propozim Vendimet për shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të përgjithshëm

Gjatë periudhës raportuese, KPF ka pasur në rend pune këto propozim vendime që kanë të bëjnë me shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave private:

Propozim Vendim për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01 Nr. 06-350-9402/2016 të datës 30.03.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik ZK në Kaçanik të Vjetër, për ndërtimin e Impiantit, për trajtimin e ujërave të zeza, Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri, Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi, Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli, Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;

Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre. KPF ka diskutuar gjerë e gjatë për këto propozim vendime, ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje.

4.8 Propozim Vendime për formim të komisioneve

Në këtë drejtim, KPF ka shqyrtuar:

Propozim Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut; Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë Për 99 vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Propozim Vendim Për Formimin e Komisionit Vlerësues Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës; Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, të pronës së paluajtshme të komunës; Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve’ Sh. A. Kaçanik. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025. Për të gjitha këto propozime vendime KPF ka diskutuar, e ka dhënë mendimin e vet dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

4.9 Propozim vendimet për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

KPF gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar: Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec, Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite, Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi. Propozim Vendim për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec.

Këtyre çështjeve iu është kushtuar rëndësi e veçantë, është kërkuar sqarim nga drejtoria përkatëse dhe të njëjtat i janë rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim. KPF-a sa herë që i adresohen propozim vendime të kësaj natyre, i sugjeron ekzekutivit të komunës që të kenë kujdes për mos cenimin e Planit Zhvillimor të Komunës –PZHK, ndërkaq kërkon që komuna të ketë sa më parë që është e mundur PZHK të ri. Në anën tjetër, KPF sugjeron që të ruhet tokat bujqësore, sepse fondi i tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut është shumë i vogël.

4.10 Planet e Punës dhe Raportet e Punës

KPF gjatë periudhës raportuese ka pasur në shqyrtim këto plane dhe raporte të punës:

1. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;
2. Plani Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024;
3. Plani i Veprimt në Mjedis, me veprim klimatik,
4. Plani i punës i Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
5. Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028;
6. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2024;
7. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;
8. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023;
9. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023;
10. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit;
11. Raporti i Përformancës komunale për vitin 2023.

Këtyre çështjeve KPF iu ka kushtuar rëndësi të veçantë, ashtu që i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës të theksuara si më lartë ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim apo sa për njoftim.

4.11 Çështjet të tjera me rëndësi për komunën

Nga çështje tjera, KPF gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar këto informata:

Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës për vitin 2023;

Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2023;

Informatë për përfundimin e Gjysmëvjektorit të Parë të Vitit shkollor 2023/2024;

Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2023;

Informatë e drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2024/2025;

Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e Vitit Shkollor 2023/2024.

Edhe këtyre çështjeve iu ka kushtuar KPF rëndësi të veçantë, ka kërkuar sqarime shtesë nga organet kompetente lidhur me statistikën e prezantuar në këto informata. Të Informatat e arsimit ka shprehur shqetësim për numrin e mungesave të arsimtarëve dhe të nxënësve, zvogëlimin e numrit të nxënësve sidomos në shkolla të mesme dhe ka kërkuar gjetjen e formave që numri i nxënësve në këto shkolla mos të zvogëlohet. Këto informata, pas shqyrtimit të thukët, ia ka adresuar KK në procedurë për shqyrtim.

5.SEKTORI I KUVENDIT

Punët dhe detyrat e punës së KPF-a përgatiten nga një zyrtar i punësuar në Sektorin e Kuvendit të Komunës dhe nga një zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtarëve, përgatiten mbledhjet e KPF-a, përgatitet materiali i nevojshëm, përpilohet Procesverbali i mbledhjes dhe Shkresat tjera të dalë nga mbledhjet e kësaj trupe punuese dhe të njëjtat arkivohen për nevojat e Shërbimit Civil të Komunës. Të njëjtat punë këta zyrtarë kryejnë edhe për Kuvendin e Komunës dhe për Komitetin për Komunitete.

6. P Ë R F U N D I M

KPF është i mendimit që veprimtarinë e vet në të ardhmen do t'i orientoj në arritjen synimeve në realizimin e projekteve kapitale më rëndësi ekonomike, duke u bazuar në planet zhvillimore dhe realizimin e projekteve kapitale më prioritet sipas Listës së aprovuar, ndërkaq vlerëson se ka nevojë të bëhet më tepër në: Zhvillimin ekonomik të komunës, Shtimin e të hyrave vetjake komunale, Zbutjen e papunësisë, Ngritjen e mirëqenës sociale, Çështjen e banimit social, Kujdesin primar shëndetësor, Mbrojtjen e ambientit, Ngritjen e cilësisë në arsim, Përmirësimin e infrastrukturës shkollore, Zbatimin e rregullave të ndërtimit, Ofrimin e Shërbimeve publike sa më cilësore, Nevojën për shtimin e subvencioneve dhe transfereve në sektorët: Arsim, Shëndetësi dhe Bujqësi, Përmirësimin e infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim).

Për Komitetin për Politikë dhe Financa
Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	14.03.2025	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	01	Shtojcë	60/01-5908 -1



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



RAPORT PUNE

I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024

Kaçanik, Mars 2025

RAPORT PUNE I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024

HYRJE

Komiteti për Komunitete është trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës. Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

Komiteti ka për detyrë t'i rekomandoj kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

DETYRAT DHE PËRBËRJA E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, detyrat e Komitetit për Komunitete janë:

- shqyrtimin e politikave komunale,
- shqyrtimin e praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Ky komitet i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të mirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën për të u avancuar, shprehur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komiteti për komunitete përbëhet nga pesë (5) anëtarë:

1. Lejla Muhaxheri –Çaka	PDK	anëtar
2. Arta Avdiu-Tusha	LVV	anëtar
3. Betim Shala	LDK	anëtar
4. Ekrem Livoreka	AAK	anëtar
5. Arben Thaqi	OJQ Shoqëria civile	anëtar.

Me Komitetin për Komunitete udhëheq, Ekrem Livoreka, i zgjedhur sipas vendimit të Komitetit për Komunitete, me shumicë votash.

Aktiviteti i Komitetit për Komunitete për gjatë vitit 2024 është zhvilluar në takime të rregullta në bazë të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete.

Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta, ashtu siç janë paraparë në Planin e punës së këtij komiteti, kjo tregon për përmbushje të planit 100%.

Mbledhjet e Komitetit për Komunitete kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive, prezenca e anëtarëve në mbledhje ka qenë e rregullt, në mbledhje ka mbretëruar një frymë e punës dhe bashkëpunimit në mes të anëtarëve të përfaqësuar në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e Komitetit për Komunitete është mbajtur procesverbal nga sektori i kuvendit, i cili është aprovuar në mbledhjen vijuese të Komitetit për Komunitete.

Procesverbali i mbledhjes është bërë transparent në faqen zyrtare të komunës. Për të gjitha mbledhjet, vlen të përmendet se 4 anëtarë të Komitetit për Komunitete janë kompensuar sipas udhëzimit administrativ për kompensimin e stafit politik në komunë, me përjashtim të anëtarit nga OJQ-Shoqëria civile, Arben Thaqi, kundër se është përcjellë raporti i pjesëmarrjes nga sektori i KK, drejtorja për Buxhet dhe Financa, ka shprehur se kanë marrë konfirmimin se nga aspekti ligjor i takon kompenzimi, mirëpo procedrat për pagesë kanë filluar të bëhen përmes listës së pagave por nuk është aprovuar nga Divizioni i Pagave në Thesarë, sepse pagesa duhet të bëhet përmes SIMFK, kategoria mallra dhe shërbime, andaj ky obligim do të kryet në momentin që do të alokohet buxheti i vitit 2024, edhe pse jemi në vitin e fundit ende nuk është kompensuar. Në mbledhje janë ftuar edhe drejtorët e drejtorive komunale për tema të caktuara për me dhënë sqarime të nevojshme, të cilët kryesisht iu kanë përgjigjur ftesës vet apo kanë dërguar ndonjë zyrtar nga drejtoria përkatëse si dhe të ftuar kanë qenë edhe komandanti i stacionit policor në Kaçanik dhe drejtori aktual i QKMF-ës z. Sinan Zeneli.

Lidhur me përgjegjësitë e këtij komuniteti, kemi pasur bashkëpunim me zyrtarët e OSBE, materiali i mbledhjes i është dërguar zyrtarëve të OSBE-së Jeton Lika, kemi mbajtur edhe trajnime të organizuara nga OSBE dhe DEMOS. Meqenëse komuna e Kaçanikut nuk ka minoritete, komiteti për komunitete është munduar t'i trajtoj disa tema të cilat i prekin interesat e komuniteteve, OJQ dhe grupeve tjera të interesit, por pa pasur mundësi të bëjë ndonjë zgjidhje.

ÇËSH TJET E SHQYRTUARA NGA KOMITETI PËR KOMUNITETE

1. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;

Komiteti për Komunitete ka hartuar një Plan Pune ku janë paraqitur objektivat e Komitetit për Komunitete për vitin 2025, i cili plan pune është miratuar nga Kuvendi i Komunës. Komiteti për Komunitete gjatë periudhës raportuese është munduar t'i përmbush në një formë objektivat e paraqitur si në këtë plan pune, duke trajtuar çështje që janë në interes të qytetarëve, OJQ apo grupeve tjera të interesit, është informuar dhe ka debatuar për çështje të caktuara, por nuk ia ka arritur sa duhet, sepse çdo objektivë e paraqitur si në planin e punës, ka edhe koston financiare, dhe ky komitet nuk është vendimmarrës. Në këtë plan pika e cila ka qenë e paraparë (Gjendja e furnizimit me energji elektrike në komunën e Kaçanikut) është hequr dhe ne si grup kemi propozuar që këtë vit të realizojm një vizitë në institucionet e Handikos me temë: Të drejtat e qytetarëve me aftësi të kufizuar në komunën e Kaçanikut. Si pikë e re është shtuar edhe: Kushtet e bujqëve në komunën tonë, ku është planifikuar takim me bujqit dhe vizit fermerëve.

2. Gjendja e furnizimit me energji elektrike në Komunën e Kaçaniku

Në këtë temë është paraparë të realizohet një vizit tek zyrat e KEDS-it për tu njoftuar rreth gjendjes së energjisë elektrike problemeve, sfidave dhe gjithqka që ka të bëjë me energjinë elektrike në vendin tonë, mirëpo vizita nuk ka mund të realizohet për arsye se zyrtari nuk ka qenë i lirë në kohën kur ne kërkuam të realizohet vizita.

Në këtë mbledhje anëtarët e komitetit për komunitete ngritën disa shqetësime që kanë të bëjnë me problemet me trafot ku për shkak të shtimit të numrit të popullsisë u kërkuar të bëhet edhe shtimi i trafave dhe përmirsimi i tyre aty ku është nevoja. Problem tjetër u diskutua rrjeti, sepse rrjeti në shumë vende është i vjetër dhe i dobët dhe duhet të riparohet. Problemet e vazhdueshme të energjisë elektrike nëpër fshatëra, vendosja e shtyllave të betonit në mënyrë jo të rregullt dhe në thellësi jo të duhur që shpesh herë paraqesi një rrezik madhor për qytetarët e atij fshati ishin vetëm disa nga shqetësimet që ngritën anëtarët e këtij komuniteti.

Një problem me të cilin po ballafaqohen ende qytetarët e komunës sonë, është padyshim ndërprerja e energjisë elektrike dhe tarifët teje të larta shqetësime këta të cilat vazhdojnë të mbesin ende prezent në komunën tonë.

3. Gjendja e Arsimit në Komunën e Kaçanikut

Sipas drejtorit të arsimit mësimin e vazhdojnë 5433 nxënës të cilët udhëhiqen nga një staf arsimor me punëtor Teknik me staf profesional janë 529.

Lëvizje të punëtorëve nuk ka pasur dhe procesi mësimorë është zhvilluar pa probleme. Përkrah të zvogëlimit të numrit të nxënësve me njoftim nga Ministria Arsimit është dashur të zvogëlohet numri i punëtorëve për 3.

Kanë qenë 542 mesimdhënës mirëpo me uljen e mesimdhënësve deri në 529.

Drejtoria e Arsimit ka planifikuar dy qerdhe shkollore (qerdhja në Rekë) për të cilën është ndarë parcela dhe është dhënë leja e ndërtimit e cila është e paraparë për 40 fëmijë dhe qerdhja në Kaçanik të vjetër për të cilën Komuna i ka kryer të gjitha procedurat në bashkëpunimin me IPA fondin.

Për shkollën "Emin Duraku" drejtori theksoj se është me kod të ministrisë dhe se drejtorja e ka dorëzuar dokumentacionin në ministri.

Kompania për dizajnim të projektit ka bashkëpunuar me komunën dhe ia ka dërguar një projekt ideor të cilin ia kanë vlerësuar për herën e parë, ministria e ka percjellë numrin e nxënësve gabim dhe projekti nuk është bërë me standarte siq duhej.

Gjithashtu kompanisë është përgjigjur që prej ministrie e ka marrë këtë numër për 550 nxënës dhe e kanë bërë projektin, kurse drejtori e ka dorëzuar me 104 nxënës dhe pohoi se jemi në fazën e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe se ata kanë premtuar se këtë vitë do të filloj tek Emin Duraku.

Planifikime për salla të edukates fizike ka pasur me të gjitha shkollat që kanë një numër më të madh të nxënësve të cilat kanë shkuar sipas planit.

Shqetësimi i drejtorit ishte pastërtia në shkollën Emin Duraku në Dushkaj ku shprehi se do e fus në funksion me pas sapun dhe me pas letër 70% dhe se e veqanta e tij është që nuk le shkollë pa e shiqu pjesën e higjienës.

Prioriteti i tij ishte me iu ndihmu prindërve të cilët i kanë fëmijët me nevoja të veçantë dhe se nuk ka fëmijë në komunë që nuk është subvencionu me një pjesë të udhëtimit dhe ndihmave për ti trajtuar.

4. Të drejtat e qytetarëve të Komunës së Kaçanikut

Për të drejtat e qytetarëve vetë qytetarët duhet të kenë të drejtën të japin opinione, të shprehij pakënaqësi dhe të debatojnë për prioritetet e komunës.

Pjesëmarrja fuqizon qytetarët të marrin vendime dhe ti pranojnë vendimet e marra, por edhe nënkupton bashkëpunim mes institucioneve dhe qytetarëve për qështjet të cilat janë në interesin e të gjithëve.

E drejta për zhvillim të qëndrueshëm është e drejtë e njeriut prandaj edhe komunat duhet që të sigurojnë standardet më të larta në edukim, shëndet, mbrojtje të ambientit dhe në politika tjera sociale.

Po ashtu, edhe qeveritë lokale e kanë obligim të ofrojnë shërbime të caktuara duke përfshirë edukim, shëndetësi, strehim, trajnimin e ujërave të zeza dhe ujë të pijshëm.

Gjithëpërfshirja është ndër parimet kryesore të qeverisjes së mirë e cila u mundëson gjithë qytetarëve të marrin pjesë pa marrë parasysh moshën, gjininë, racën apo fenë pasi gjithë janë të barabart në vendimmarrje.

Si e drejtë elementare konsiderohet pjesëmarrja e grupeve pa dallim race, gjinie, besimi fetar në planifikim të qytetit.

Qeverisja e mirë ka të bëjë me procesin më të mirë të mundshëm për marrjen e vendimeve dhe se qeverisja e mirë është e lidhur me performancën e institucioneve kontributin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes dhe zbatimit të vendimeve.

Kompetencat e pushtetit lokal rregullohen me kushtetutën e Kosovës dhe me ligjin për Qeverisje lokale. Qëllimi i këtij ligji është që të mundësohet ekzistimi i një sistemi të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike.

Për të arritur modele të suksesshme dhe të qëndrueshme, për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve, mënyra më e mirë dhe më e sigurt është përmes mekanizmave të strukturuar dhe të institucionalizuara.

Disa prej mekanizmave janë: informimi publik, konsultimi publik, e drejta e peticionit, iniciativat e qytetarëve, referendumi.

Si komitet për komunitete shprehëm shqetësimet për mos pjesëmarrje të duhur në debate publike.

5. Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ

Në vitin 2022, Komuna e Kaçanikut ka ndarë subvencione për organizatat joqeveritare (OJQ) që veprojnë në këtë komunë. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka përgjegjësinë për këtë proces. Ndarja e subvencioneve është bërë me qëllim të përmirësimit të buxhetit dhe për të mbështetur aktivitetet e OJQ-ve. Ky proces zhvillohet vit pas viti dhe ne me një thirrje i kemi subvencionua të gjitha OJQ-të, me një shumë prej 70.000.00 €, në vitin e dytë 2023 i kemi publikuar dy thirrje për shkak të rrethanave të tilla dhe nuk kemi dashur që ndonjë OJQ të mbetet pa u subvencionua sepse këto para ndahen për ta, shuma e ndarjeve të mjeteve ka qenë e njëjtë me vitin 2022, ndërsa për vitin 2024 subvencionet kanë pësua një ngritje nga 70.000.00€ kanë kalua në 85.000.00 €, që mund themi se ka qenë një ngritje tjetër sepse sipas kërkesave të cilat kanë dalë në debate publike që i kemi mbajtur me OJQ-të në vitin 2022 kanë qenë kërkesë e veçantë e OJQ-ve blerja e një minibusi vlera e tij cilit ka qenë 30.000.00€.

Minibusi është në palestrën sportive dhe është në funksion mirëpo jemi në mungesë të një shoferi por megjithatë jemi duke gjetur mënyrën veç ka filluar sipas kërkesave të OJQ-ve është në lëvizje edhe minibusi.

Këtë vitë jemi detyruar me i publiku dy thirrje publike për shkak që në thirrjen e parë nuk kanë aplikuar të gjitha organizatat joqeveritare që ligjërisht kemi mundur mos me realizua thirrjen e dytë por ne jemi idhtarë për me i subvencionua organizatat joqeveritare sepse këto organizata bashkëpunojnë ngushtë me komunën e Kaçanikut dhe me Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport.

Thirrja e parë në vlerë prej 67,450.00 euro është:

KULTURË

Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo – Artistike

Qendra Kulturore "Kaçaniku" 7.000.00 €.

Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë "Kaçaniku Këndon".

Shoqëria Kulturo Artistike Gryka e Kaçanikut 5,000.00 €.

Organizimi i aktivitetit për mërgimtarët, me moton " Ju jeni pjesë e atdheut"

Shoqëria Kulturore Artistike Tingujt e Vendlindjes 2,000.00 €.

Subvencionim/aktivitetet sipas planprogramit të OJQ-ve

Qendra Kulturore "Kaçaniku" 2,000.00 €, Shoqëria Kulturore Artistike Tingujt e Vendlindjes 3,500.00 €, Shoqëria Kulturo Artistike Gryka e Kaçanikut 2,000.00 €, Shoqata Kulla e Gurit 1,500 €.

RINI DHE SPORT

Klubi i Futbollit të Femrave Bazeli 2015 Biçec - Kaçanik 4,000.00 €, Klubi i Futbollit Lepenci Kaçanik 17,700.00 €, Klubi Basketbollistik Kaçaniku-Meshkujt 4,000.00 €, Klubi Volejbollit për Femra Kaçaniku 4,000.00 €, Klubi i Mundjes Kaçaniku 3,500.00 €, Klubi Volejbollit Kaçaniku Meshkujt 2,900.00 €, Klubi Basketbollistik Lepenci 1,800.00 €, Shoqata e Peshkatarëve Sportiv dhe Rekreativ Trofta e Lepencit 1,000.00 €, Kampi i Artistëve Mural 2,150.00 €, Fondacioni Bonevet Kaçanik 1,400.00 €, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal-Kaçanik 2,000.00 €.

Tek thirrja e dytë shuma e ndarë është në vlerë prej 16.550.00 €, në rini dhe sport janë të paraparë shuma prej 15.550.00 euro dhe Kulturë vlera prej 1,000.00 €.

Bërje e thirrjes dy herë nga ana e drejtoreshës për ndarje të subveconeve anëtarët e komunitetit për komunitete e shohin si interes i OJQ-ve, duke ju ofruar mundësi edhe atyre të cilët kanë ngec për shkak të afateve kohore, andaj ata u shprehën faleminderues ndaj drejtoreshës për këtë vendim.

Interesim gjithashtu patë dhe për çështjen e stadiumit, konkretisht kontrata e saj a është shkëputur me qëllim që të krijohet mundësia për një kontratë të re apo ende nuk është shkëputur, ku sipas saj qendron kjo pergjigjije : Në momentin kur kam ardhur në pozitën e drejtoreshës, hapi i parë që kam ndërmarrë ka qenë çështja e stadiumit të futbollit, pastaj mbas gjashtë muajve kam bërë një takim me ministrin e kulturës këtu në Kaçanik, i cili na premtoi se projekti i parë u ndal njëherë për shkak pandemisë por mbas pandemisë kostoja e çmimeve u rrit dhe punëkryesi ka kërkuar shtesë por këtu nuk mundem me fajësua ministrin sepse ai na i ka hapur të gjitha rrugët sa i përket ministrisë por punëkryesi nuk ka shkuar me i rregullua letrat për 20%, me njëfarë fjalë nuk ka pas interes me vazhdua më, por për shkëputjen e kontratës zyra e prokurimit këtu e ka zvarritur këtë proces sepse nuk vinte kompania me bë ndërprerjen e punimeve, njëherë ka qene dashur të bëhet ndërprerja e punimeve e pastaj me ju shkëput kontrata. Që dy muaj është shkëputur kontrata dhe unë ja kom paraqitur ministrit të kulturës me dokumentacion dhe me kopje fizike por edhe përmes emali adresës, sepse shkresa e fundit e ardhur nga ministri është kështu “shkëputë kontratën pastaj sjelle projektin e ri”, për informim është duke u bërë projekt i ri pastaj ta shohim reflektimin e ministrisë. Shqetësim nga ana e drejtoreshës kishte të bëjë për mosraportim të të dhënave nga ana e Ojq-ve ku si pasoj e kësaj detyrohen që në vitin paraardhës të diskualifikohen.

6. Rastet sociale në Komunën e Kaçanikut;

Në këtë takim konkretisht u diskutua më shumë rreth pilot projektit për skenën e ndihmës sociale.

Sipas z. Xhelal Gashi mundësia për me apliku është përmes platformës eKosova, e cila na ka qitur edhe një detyrë shtesë sepse përveç kësaj palët të cilët nuk kanë njohuri si të aplikojnë duhet me ardhur prapë tek ne me krye aplikacionin, por ajo çka është e mirë nëse ky pilot projekt del i suksesshëm mbetet të shihet. Gjithashtu kanë angazhuar edhe nga një praktikant nëpër qendra për pune sociale i cili ka me u marr vetëm për data bazën, për ti këshilluar palët për ato që nuk kanë njohuri për të aplikuar përmes platformës eKosova.

Anëtarët e komunitetit për komunitete u interesuan rreth përparsive dhe tv metave që ka ky pilot projekt, ku si përparësi u cek mosha e fëmijëve, përpara ka qenë limiti i moshës 5 vjeçare, me automatizëm ka qenë dashtë me ndërprerë, tash ajo nuk është, është një formë tjetër fatkeqësisht pala ka me i dhënë të dhënat përmes e platformës, ka të drejt secili me aplikuar, pak e krijon mundësin edhe të ato qe për një kohë shkurt punojnë me pas një periudhë tre mujore testuese. Përshembull ka njeri qe ka hyrë në punë një muaj ditë dhe ka dal prej punë dhe ti je detyrua me ja ndal socialin. Tash ajo nuk është d.m.th. tre muaj ditë ka mundësi me vazhdua por mbas tre muaj ndërprehet. E metë e saj për shumicën e rasteve ka me qenë mbas aplikacionit të cilën aplikon.

Trajnimi i stafit për këtë pilot projekt si dhe vështërsit që qytetarët mund të kenë në shfrytëzimin e platformave elektronike mbeten vetëm disa nga shqetësimet që z.Xhelal ngritin për këtë pilot projekt.

Dhuna në familje, rritja e numrit të fëmijëve që po kërkojnë lëmosh, kriteret për adaptim të fëmijëve në komunën tonë ishin edhe disa nga temat që u diskutuan në këtë takim.

Momentalisht në komunën tonë janë 539 shfrytëzues të skemës sociale

7.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

z.Halim Shehu ka raportuar 102 raste.Prej tyre, veprat penale janë si në vijim:

- Vjedhje : 12 raste
- Vjedhje e rëndë: 3 raste
- Vjedhje e pyllit: 1 rast
- Dhunë në familje: 4 raste
- Ngacmim: 5 raste
- Ngacmim seksual: 1 rast
- Falsifikim I parasë: 2 raste
- Falsifikimi dokumenteve: 2 raste
- Lendim i lehtë trupor: 6 raste
- Blerje,posedim,shperndarja dhe shitja e narkotikëve: 3 raste
- Asgjësim apo dëmtim ose heqja e instalimeve publike: 3 raste
- Asgjësim apo dëmtim I pasurisë: 3 raste
- Kanosje: 10 raste
- Kanosje ndaj personit zyrtar: 2 raste
- Sulm: 2 raste
- Sulm ndaj personit zyrtar: 2 raste
- Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar i armëve: 5 raste.Këto janë të dhënat e raportuara për periudhën përkatëse.

Në këtë temë është diskutuar për sigurinë në Komunën e Kaçanikut në përgjithësi dhe sigurinë e shkollave në veqanti.Nga antarët e Komitetit për Komunitete është kërkuar nga Komandanti i stacionit policor në Komunën e Kaçanikut që të rritet siguria nëpër shkolla, në bashkpunim me drejtorin e arsimit që të ketë kontrolla të shpeshta nëpër shkolla me qëllim parandalimi të lëndëve narkotike,posedimin e armëve të ftohta.Anëtarët e Komitetit vazhduan me pyetje dhe kërkesa: Kërkesa ishte nga banorët e rrugës “Idriz Seferi” të cilët ankohen për dëmtimin e rrugës nga kamionët me pesh të rëndë.Me mbylljen e rrugës magjistrale, këta kamionë tani po qarkullojnë në këtë rrugë,e cila nuk është e përshtatshme për një ngarkesë të tillë.Sipas shenjave të komunikacionit ata nuk kanë të drejtë të qarkullojnë aty

z.Halim Shehu jep përgjigje se ne jemi duke shqiptuar gjoba, por nuk jemi 24 orë në atë rrugë.Gjobat janë të mjaftueshme, megjithatë kam marrë ankesa lidhur me shqyrtimin e gjobave, sepse ata thonë se nuk u janë bërë rrugë alternative.

Një shqetësim tjetër që u ngrit nga anëtarët e komitetit për komunitet kishte të bëjë rreth mosfunksionimit të kamerave të sigurisë. Z.Halim Shehu për kamerat e sigurisë thotë që një vitë e diqka,kamerat e sigurisë nuk janë funksionale.Ne kemi ngritur shqetësimin por kryetari i Komunës nuk ka treguar gadishmëri për t'i siguruar ato.Ai thotë se nuk ka donacione dhe nuk është e paraparë,megjithatë,të gjitha Komunat tjera kanë donacione nga Komunat e veta.Ne i menagjojmë kamerat, por komuna është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe vendosjen e tyre, kamerat janë të gjitha të çmontuara, ato janë dalë prej rrjetit gjatë punimeve në rrugë që keni bërë, do të thotë se i keni hequr,u shpreh ai.

Shqetësim tjetër kishte të bënte rreth vërshimeve,në rast se do të ndodhnin cilat do të ishin masat e ndërmarra nga ju?Në rast vërshimi, ne kemi planet operative.Për pastrimin e rrugëve, kemi një kontratë, që do të thotë se komuna ka një marrëveshje me kompaninë e cila del edhe gjatë ditës

dhe natës sa herë që kemi nevojë. Nuk ka ndodhur asnjëherë që të mos dalin. Kryesisht, bllokohen më shpesh rrugët Ivajë Kotlinë.

Siguria nëpër shkollë, dhuna në familje, prerja e pyjeve, ishin disa nga shqetësimet tjera për të cilat morën përgjigje anëtarët e komunitetit për komunitete.

8. Gjendja aktuale e QKMF-së në Komunën e Kaçanikut

Në këtë mbledhje raportoje drejtori i QKMF-së z.Sinan Zeneli, sipas tij; Puna gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka shkuar mirë. Puntorët kanë respektuar orarin dhe disiplinën në punë, dhe të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer siç është parashikuar.

Gjatë periudhës janar-qershor 2024, në QKMF dhe në terren janë kryer gjithsej 99,658 shërbime shëndetësore. Prej tyre, janë realizuar 44,906 kontrolla mjekësore, 55,992 shërbime infermierike, dhe janë referuar për në spital 4,771 raste. Në urgjencë, janë trajtuar 16,539 pacientë, janë dhënë 20,239 injeksione dhe 10,380 infuzione. Po ashtu, janë realizuar 6,954 lidhje dhe pastrime plagësh, 3,061 EKG, 1,471 inhalime dhe 1,682 vizita shtëpiake.

Për grupet specifike, janë realizuar 921 vizita shtëpiake për nënat dhe fëmijët nga mosha 0-3 vjeç, dhe 6,302 përshkrime dhe intervenime mjekësore janë realizuar në ordinancat private dhe spitalet që bashkëpunojnë me QKMF-në. Njësia e vaksinimit ka realizuar 3,256 shërbime, ndërsa janë kryer gjithsej 601 kontrolla mjekësore stomatologjike. Në laboratorin e QKMF-Doganaj janë kryer analiza laboratorike dhe biokimike për 159 pacientë, në laboratorin e QKMF për 6,803 pacientë dhe në njesinë e rentgenit janë shërbyer 2,356 pacientë. Shërbimet në fushën e pediatriisë kanë përfshirë 2,401 pacientë, në gjinekologji 1,069 në pulmologji 366 dhe në radiologji 229.

Gjatë periudhës maj-qershor, janë realizuar gjithsej 3,743 shërbime të tjera- participim.

Anëtarët e Komitetit u interesuar rreth aparaturës së mamografisë e cila së shpejti do të silllet në ambientet e Qkmf-ës, u interesuan rreth datës dhe trajnimit të stafit për përdorimin e kësaj aparature.

Z.Sinan Zeneli: Realistisht, është një lajm i mirë që po sjellim aparaturën për mamografi. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Kryetari dhe Islamic Relief, dhe vlera e saj është, por nëse nuk gaboj, 108.000.00 €. Përdorimin e kësaj aparature shumica e stafit e njohin, por për këtë lloj aparature kërkohet një trajnim i veçantë. Besoj se trajnimet i kryem, pasi Ferizaj ka një qendër të specializuar për mamografin, me gjithë stafin atje, dhe jamë i sigurt që ata kanë kryer trajnimet e nevojshme. Ky është një lajm shumë i mirë, pasi qytetarët tani mund të marrin shërbime edhe këtu, pranë nesh.

Anëtarët e Komitetit ngriten shqetësimet e tyre edhe rreth gjendjes me barnave esenciale, veqanërisht insulinës, si dhe sa shpesh viziton AMF-të nëpër fshatra dhe a janë ato funksionale.

Sa i përket punës shëndetësore, situata është si më poshtë: në Doganaj aktualisht janë rreth 300 pacientë Brenda muajit, në Glloboshicë janë 73 pacientë, ndërsa Begraca është në gjendje të mirë. Stagova ka rreth 20 pacientë, ndërsa Bobi vetëm 10 pacientë. Kjo do të thotë se po shkojmë ngadalë, por ne nuk do t'i mbyllim këto AMF.

Të shtohen shërbimet e polmologut, rritja e stafit për infermjer/e, sigurimi i një psikologu në ambientet e Qkmf-ës, lidhja e një kontrate të rregullt me një gjinekologje dhe radiolog ishin vetëm disa nga kërkesat e anëtarëve, të cilat morën përgjigje nga z.Sinan Zeneli.

9. Gjendja bizneseve në Komunën e Kaçanikut

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit për një periudhë të shkurtër mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznese. Po ashtu përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu jepen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme sipas nevojës, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

Nga të dhënat që posedon Qendra komunale për regjistrimin e biznesit deri në tetor të vitit 2023, ushtrojnë aktivitete biznese gjithsej 1600 ndërmarrje. Nga bizneset e regjistruara 75% janë Biznese Individuale ndërsa 23% biznese Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe pjesa tjetër përfshin Shoqëritë Aksionare - Ortakëritë, Bizneset e huaja dega në Kosovë etj.

Ndërmarrjet të cilat kanë pronar të gjinisë femërore janë 17% (tipi biznesit tek pronaret femra fokusohet më shumë në biznese individuale). Ndërsa pronaret meshkuj përfshin rreth 83% te bizneseve. Viteve të fundit ka rritje të bizneseve të tipit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ndërtimtaria. Tregtia përfshinë 31% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 27%, ndërtimtaria 11%, ndërsa 31% përfshihen sektorët tjerë. Këta sektorë janë shquar për rritje gjatë viteve të fundit, ndërsa rënie nuk është shënuar në asnjë sektor. Përkundër potencialeve të Kaçanikut për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar, me vetëm 4%.

Dominimi i sektorit privat është një tregues i ndërmarrjes në nivel komunal, i cili ka nevojë për përkrahje të mëtejme, duke pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Numri më i madh i ndërmarrjeve është i përqendruar në Kaçanik, si qendër komunale zonën urbane janë të koncentruar 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal. Vendbanimi i dytë për nga numri i ndërmarrjeve është fshati Doganaj 6%, e pasuar nga Kaçaniku i Vjetër, Dubrava etj. Gjatë viteve të fundit, përgjithësisht numri i ndërmarrjeve në të gjitha vendbanimet është rritur, përveç në disa fshatra të vogla ku numri ka mbetur konstant.

Statistikat nga regjistrimi i bizneseve të grupuara sipas llojit të bizneseve.

Gjithsej biznese të regjistruara nga 01/01/2024-31/10/2024 janë 122.

SH.P.K, janë regjistruar 88 biznese, B.I. janë regjistruar 34 biznese.

Gjithsej biznese të regjistruara nga 01/01/2023-31/10/2023 janë 134.

SH.P.K. prej 01/01/2023-31/10/2023 janë regjistruar 86 biznese, B.I. prej 01/01/2023-31/10/2023 janë regjistruar 48 biznese.

Diferenca përgjatë vitit 2024 ka 12 Biznese të regjistruara më pak se në vitin 2023

Shuarje të biznesit - 9 biznese.

10 Aktivitete që shërbejnë më së shumti nga bizneset në vitin 2024 deri me 31 tetor:

Aktivitet shërbyese të pijeve - 17 biznese;

Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël - 12 biznese;

Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit - 12 biznese;

Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore - 12 biznese;

Punime suvatimi - 11 biznese;

Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve - 11 biznese;

Tregtia me shumicë e mobileve, pajisjeve të ndriçimit, dyqaneve - 11 biznese;

Aktivitetet e tjera të specializuara të ndërtimit p.k.t. - 10 biznese;

Tregtia me shumicë jo e specializuar - 9 biznese;

Prodhimi i mobileve të zyrave dhe dyqaneve - 9 biznese.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve në Komunën e Kaçanikut, në kuadër të Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe te vogla" këtë vit ka subvencionuar 15 biznese. Fondi 56.000.00€ dhe shpenzimet afër 30.000.00€.

Anëtarët e komitetit për komunitet ngritën shqetësimin e tyre për mos shfrytëzimin e mjeteve dhe kërkuan nga drejtoresha që sipas mundësive të ketë dhe një thirrje të dytë për ndarje të subvencioneve me qëllim që këta mjete të shfrytëzohen dhe njëkohësisht të ndihmohen sa më shumë biznese.

Fondi që ka mbetur në dispozicion, pra 27.000.00€, do të transferohet për vitin tjetër, pasi janë të ardhura vetanake. Do të ketë një thirrje vitin tjetër dhe fondi do të jetë pak më i madh, sepse këto mjete do të bartën dhe do të mbështesin dy kategori, ishte përgjigjija e drejtoreshës për këtë rast. Mungesa e fuqisë punëtore, kriteret për ndarje të subvencioneve, ishin disa nga pikat që në vazhdimësi u diskutuan nga anëtarët e komitetit për komunitet.

10. OVL UÇK-së në Komunën e Kaçanikut

Kemi pasur një vizitë të planifikuar me OVL, por na është njoftuar se është anuluar nga shoqata edhe pse paraprakisht jemi dakorduar për takim.

Gjendja aktuale e Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL) në komunën e Kaçanikut është shumë vështirë të prekur nga gjendja financiare është një shqetësim i madh, sidomos në periudhën e dimrit përballen me ngrohjen dhe shpenzimet e rritura për energji elektrike gjatë dimrit. Kjo është edhe më shqetësuese për ata që janë lënë anash në mbështetje nga institucionet shtetërore. Shoqata e veteraneve të ket hapësirë më të mirë për ta ushtruar veprimtarinë e tyre për punë më të sukseshme dhe takime të ndryshme.

Veteranët dhe invalidet gjenden në situatë të vështirë edhe përshkak të strehimit një pjesë e tyre nuk kanë as strehim që të bëjnë edhe gjumin rehat, pastaj invalidit kanë probleme të shumta për sigurim të protezave të tyre dhe mbetën në mëshirë të përkujdesës vullnetare.

Gjykata Speciale ka filluar gjykimin e veteranëve që e ka rritë më shumë presionet të veteranët e UÇK të pa mbrojtur nga shteti si në mbrojtjen e tyre përshkak të pagesave të shumta për avokatët e tyre një pjesë janë thirr si dëshmitar në procesin e gjyimit.

Si komunitet për komunitet shprehëm shqetësimin për planet shkollore dhe aktivitetet për data të rëndësishme të bëhet më shumë vizita të monumentet historike që tregojnë për luftën e lavdishme të UÇK, luftë e cila na solli lirin dhe shtetin.

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Ekrem Livoreka

